



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Nr. 1750/2 Prot.

Vlorë më, 16.06.2026

VENDIM

Nr. 32, datë 16.06.2026

PËR

**MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE, NË RREGULLOREN E
PROGRAMIT TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE, "DOKTORATË" NË
"STUDIME GJUHËSORE, LETRARE DHE KULTURORE" TË FAKULTETIT TË
SHKENCAVE HUMANE NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, dhe nenit 77 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 19, pika 1, shkronja "dh" dhe nenit 61 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe të neneve 13 dhe 78 të Rregullores së Brendshme të UV-së, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 16.06.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë disa ndryshime në Rregulloren e Programit të Ciklit të Tretë të Studimeve "Doktoratë" në "Studime Gjuhësore, Letrare dhe Kulturore" të Fakultetit të Shkencave Humane në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Dispozitat e tjera të Rregullores së Programit të Ciklit të Tretë të Studimeve "Doktoratë" në "Studime Gjuhësore, Letrare dhe Kulturore", të cilat nuk preken nga ky vendim, mbeten në fuqi.
3. Ngarkohen Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. AURELA SALIAJ

Konceptoi, Koordinator i Organeve Kolegjiale
Gilberta Selami



Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

RREGULLORE

**E PROGRAMIT TE CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE “DOKTORATË” NË
“STUDIME GJUHËSORE, LETRARE E KULTURORE” TË FAKULTETIT TË
SHKENCAVE HUMANE, TË UNIVERSITETIT “ISMAIL QEMALI”, VLORE**

Miratuar nga Senati Akademik me Vendimin Nr. 43, datë 15.11.2021, i ndryshuar nga Senati
Akademik me Vendimin Nr. 32, datë 16.06.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

TABELA E PËRMBAJTJES

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	4
Neni 1 Qëllimi	4
Neni 2 Baza ligjore	5
Neni 3 Emërtimi dhe statusi i programit.....	6
Neni 4 Objektivat e programit	7
Neni 5 Objektivat formues të programit	8
KREU II ORGANIZIMI I STUDIMEVE TË DOKTORATËS	10
Neni 6 Programi i studimit të Doktoratës	10
Neni 7 Kohëzgjatja e studimeve	11
Neni 8 Programi individual për aftësim të pavarur të doktorantit.....	15
Neni 9 Strukturat akademike dhe organet përgjegjëse për studimet e doktoratës.....	16
Neni 10 Kriteret e pranimit.....	17
Neni 11 Procedura e aplikimit dhe regjistrimit të kandidatëve Error! Bookmark not defined.	8
Neni 12 Financimi.....	21
KREU III PËRGJEGJËSITË NË PROCESIN E REALIZIMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS	23
Neni 13 Të drejtat dhe detyrat e doktorantit.....	23
Neni 14 Roli dhe përgjegjësitë e drejtuesit shkencor.....	24
Neni 15 Përgjegjësitë e njësisë bazë	26
Neni 16 Roli dhe përgjegjësitë e komisionit <i>ad-hoc</i> për vlerësimin e kandidatëve për doktorantë	27
Neni 17 Roli dhe detyrat e përgjegjësit të programit të doktoratës	28
Neni 18 Roli dhe detyrat e koordinorit të programit të doktoratës.....	29
Neni 19 Roli dhe përgjegjësitë e Komisionit për Dhënie të Gradës Shkencore “Doktor”.....	30
Neni 20 Ngritja, roli dhe funksionimi i jurisë për mbrojtjen e gradës shkencore “doktor”	30
Neni 21 Sigurimi i cilësisë	31
KREU IV PËRMBYLLJA E STUDIMEVE TË DOKTORATËS	33



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
SENATI AKADEMIK

Neni 22 Mbrojtja e doktoratës	34
Neni 23 Mospërfundimi ose ndërprerja e studimeve të doktoratës	34
Neni 24 Transferimi i studimeve	34
Neni 25 Anullimi i gradës shkencore “Doktor”	35
Neni 26 Rregullat për paraqitjen e punimit	36
Neni 27 Etika në kërkim dhe integriteti akademik	37
KREU V DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT	38
Neni 28 Administrimi i dokumentacionit	38
Neni 29 Dispozitat kalimtare dhe të fundit	39
Neni 30 Shfuqizime	39
Shtojca 1 Për paraqitjen dhe stilin e punimeve të temës së doktoratës për programin e studimit “Doktoratë në studime Gjuhësore, letrare e kulturore”	40
Shtojca 2 Format i paraqitjes së punimit	50
Shtojca 3 Raportimi vjetor për ecurinë e doktorantëve	71
Shtojca 4 Projektpropozimi për temën e doktoratës	73
Shtojca 5 Vlerësimi i oponentit	77
Shtojca 6 Fletëvlerësimi për temën e doktoratës	79



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave që lidhen me aspekte të organizmit dhe realizimit të programit të studimit “Doktoratë” në “Studime gjuhësore, letrare e kulturore”, si:

- njësi(të) dhe strukturat akademike përgjegjëse për programin e studimit;
- forma dhe kohëzgjatja e programit;
- kriteret e pranimit dhe procedura e regjistrimit të kandidatëve për studentë doktoratë (në vijim: doktorant(ë));
- mënyra e organizmit dhe realizimit të studimeve dhe veprimtarive hulumtuese në kuadër të doktoratës;
- paraqitja, vlerësimi dhe mbrojtja e temës së doktoratës (në vijim: disertacionit);
- të drejtat dhe detyrat e doktoranit;
- përgjegjësitë e udhëheqësit shkencor, koordinаторit të programit, komisionit për dhënien e gradës “doktor”;
- çështje të etikës në kërkim;
- administrimi i të dhënave të çdo doktoranti lidhur me veprimtarinë kërkimore-shkencore e krijuese të tij;
- raportimin e vlerësimit të progresit të doktorantit;
- aspekte të tjera që lidhen me sa më sipër.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore bazohet në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 41, datë 24.01.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, VKM nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, VKM nr. 777, datë 26.12.2018 “Për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”, i ndryshuar, VKM nr. 75, datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, VKM nr.824, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisë kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar”, Udhëzimin e MASH nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 16, datë 08.07.2019 “Për pajisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrimin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrimin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave”, Udhëzimin nr. 29, datë 18.12.2019 “Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin nr. 10, datë 30.03.2020 “Për përcaktimin e elementeve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, Statutin e Universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës, miratuar me urdhrin nr. 197, datë 01.04.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, i ndryshuar me urdhërin nr. 287, datë 30.06.2025, të Ministrit të Arsimit, Rregulloren e Universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës, miratuar nga Senati Akademik me Vendim nr. 20, datë 11.04.2022, i ndryshuar me Vendim SA nr.88, datë 22.09.2025. Rregulloren e Etikës dhe Publikimit Shkencor të UV-së, vendimin e SA-së nr. 62, datë 11.02.2020 “Për kriteret dhe standardet për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve të përdorura për marrjen e gradës shkencore në UV”, i plotësuar me vendimin e SA-së nr. 94, datë 21.10.2020, Rregulloren për organizimin e ciklit të tretë të studimeve (doktoratë) në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, si dhe vendimin e SA-së nr. 130, datë 23.12.2025 “Për një ndryshim në Rregulloren ‘Për përdorimin e iThenticate, software-it për detektimin e plagjiaturës në veprimtarinë kërkimore dhe botuese në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, miratuar me vendim të Senatit Akademik nr. 24, datë 08.05. 2018”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

Neni 3

Emërtimi dhe statusi i programit

1. Programi i studimit “Doktoratë” në “Studime gjuhësore, letrare dhe kulturore” është program i ciklit të tretë të studimeve, doktoratë, referuar nivelit të 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, Kornizës Evropiane të Kualifikimeve dhe ISCED.
2. Ai ofrohet nga grupimi i njësive: Departamenti i Gjuhëve të Huaja në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, Fakulteti i Shkencave Humane.
3. Termat e bashkëpunimit të dy njësive detajohen në aktmarrëveshjen e grupimit të dy njësive për ofrimin e këtij programi.
4. Ky program studimi është i ciklit të tretë, “Doktoratë”, dhe zhvillohet me kohë të plotë pranë njësisë/njësive bazë bashkëpunuese në Fakultetin e Shkencave Humane kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në UV, ose me afat të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
5. Studimet e doktoratës kanë në themel të tyre kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese të pavarur, si bazë për përgatitjen e tezës së doktoratës, të nevojshme për marrjen e gradës shkencore “Doktor” dhe lidhen me projekte kërkimore të njësive bazë si dhe kualifikimin dhe rritjen profesionale të personelit akademik. Kandidati aplikon në bazë të kuotave që janë shpallur nga njësitë bazë, në kuadër të një projekti kërkimor shkencor. Njësitë bazë përgjegjëse për programin përcaktojnë projektin/projektet kërkimore, të financuara me fonde kombëtare dhe/ose ndërkombëtare.
6. Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike. Në përfundim lëshohet diploma e gradës shkencore “Doktor”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

Neni 4

Objektivat e programit

Programi i studimit “Doktoratë” në “Studime gjuhësore, letrare e kulturore” synon:

- nxitjen dhe promovimin e kërkimit shkencor të përparuar e thelluar në fusha e nënfusha të lidhura me gjuhën, letërsinë dhe kulturat përmes qasjeve bashkohore, ndërdisiplinare dhe shumëdisiplinare, si dhe duke u mbështetur tek teknologjia për të ofruar një qasje më të plotë, nga pikëpamja metodologjike dhe aplikative të çdo aspekti gjuhësor, letrar, kulturor dhe historik.
- krijimin e njohurive të reja që lidhen me fusha si gjuhësi, letërsi e studime kulturore e nënfusha të tyre si: teori e letërsisë e kulturës, kritikë letrare, komunikim ndërkulturor, studime për komunikim, studime për media, studime të filmit, analizë e diskursit, pragmatikë, semantikë, gjuhësi teksti, semiotikë, studime përkthimore, gjuhësi e aplikuar, gjuhë për qëllime të posaçme, sociolinguistikë, didaktikë e gjuhëve.
- lidhjen e këtyre njohurive dhe kërkimeve me kontekste më profesionale për zbatimin e tyre në praktikë (teknikë gjuhësorë, përkthyes, konsulentë, shkrimtarë, redaktorë, kritikë letrarë, promovues të kulturës etj.) për të kontribuar në nxitjen dhe garantimin e përdorimit të duhur të gjuhës, për të kuptuar mekanizmat gjuhësorë dhe për të interpretuar prirjet letrare e kulturore në kontekste të ndryshme socio-kulturore.
- formimin e kërkuesve të rinj përmes aftësimit të mëtijshëm për të kryer kërkim të pavarur e të zbatuar në këto fusha e nënfusha, për të realizuar punime origjinale, domethënëse e kontribuese për zhvillimet shkencore në vend, rajon e më gjerë dhe me impakt shoqëror.
- ndërkombëtarizimin e kërkimit shkencor në këto fusha e nënfusha përmes thellimit të bashkëpunimit me institucionet partnere përmes mekanizmave të mobilitetit të studentëve, organizimit të aktiviteteve dhe botimeve shkencore të përbashkëta dhe bashkëudhëheqjeve, sipas marrëveshjeve ndërinstitucionale midis universiteteve përkatëse dhe UV-së (neni 78, pika 13 e Rregullores së UV-së).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

Neni 5

Objektivat formues të programit

1. Ky program synon thellimin e formimit shkencor të studentëve të doktoratës përmes aftësimit të përparuar për të kryer kërkim dhe për të zhvilluar më tej shprehinë hulumtuese e krijuese në dobi të këtij procesi.
2. Në përfundim të këtij programi, i doktoruari do të ketë arritur këto rezultate të të nxënit:
 - a. ka përgatitur një vepër shkencore origjinale, duke dhënë kështu kontributin e vet për zgjerimin e njohurive në fushën e studimit me standarde të larta kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - b. është studiues akademik i ri i përgatitur, në gjendje të sjellë përparim shoqëror, shkencor dhe/ose kulturor për një shoqëri të bazuar në dije në një mjedis akademik ose joakademik;
 - c. zotëron metodat e aplikuara në kërkime në fushën/nënfushën e tij/saj;
 - d. identifikon pyetjet shkencore dhe i analizon në mënyrë kritike e të pavarur.
 - e. është i aftë për të diskutuar, analizuar dhe zhvilluar më tej teoritë shkencore në mënyrë kritike;
 - f. ka kompetencën dhe aftësinë për të hartuar, zhvilluar dhe kryer në mënyrë të pavarur projekte të rëndësishme kërkimore thelbësore duke demonstruar etikë në kërkim dhe integritet akademik;
 - g. është i aftë për të reflektuar mbi këto procese shkencërisht dhe teorikisht;
 - h. është në gjendje të organizojë forume shkencore, për të diskutuar gjetjet nga fushat/nënfushat e studimit me kolegë, studentë dhe ekspertë të fushës, si dhe për t'ia paraqitur dhe shpjeguar këto gjetje studentëve, audiencës akademike dhe joakademike të interesuar;
 - i. është në gjendje të shkojë përtej kufijve të disiplinës së vet dhe të integrohet në një diskurs shkencor edhe më ndërdisiplinor.
3. Këto rezultate do të arrihen përmes një programi individual për aftësim të pavarur të doktorantit, i cili do të synojë aftësimin e doktorantit në këto kompetenca themelore, shprehin e aftësi vetjake e kompetenca të tjera që lidhen me formimin e thelluar shkencor në fushën/nënfushën e kërkimit:
 - a. Kompetencat themelore përfshijnë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

- të kuptuarin sistematik të fushës/nënfushë së studimit dhe zotërimin e aftësive dhe metodave të kërkimit që lidhen me të/to;
 - aftësinë për të konceptuar, projektuar/krijuar, zbatuar dhe përshtatur një proces thelbësor kërkimi ose krijimi;
 - aftësinë për të kontribuar në zgjerimin e njohurive përmes kërkimit origjinal, me vlera e domethënëse;
 - aftësinë për të kryer një analizë kritike dhe vlerësuese dhe sintezë të ideve të reja dhe komplekse;
 - aftësinë për të komunikuar me komunitetin akademik dhe shkencor dhe shoqërinë në përgjithësi për fushat/nënfushat e tyre në mënyrat dhe gjuhët e përdorura zakonisht në komunitetin shkencor ndërkombëtar;
 - aftësia për të promovuar, në kontekstet akademike dhe profesionale, përparimin shkencor, teknologjik, social, artistik ose kulturor në një shoqëri të bazuar në dije.
- b. Shprehitë dhe aftësitë vetjake përfshijnë:
- njohjen për të kërkuar në kontekste ku ka pak informacion të posaçëm për fushën/nënfushën e kërkimit;
 - gjetjen e pyetjeve kryesore që duhet të marrin përgjigje për të zgjidhur një problem kompleks;
 - projektimin, krijimin, zhvillimin dhe fillimin e projekteve të reja dhe novatore në fushën/nënfushën e tij/saj të dijes;
 - punën në ekip dhe në mënyrë të pavarur në një kontekst ndërkombëtar ose shumëdisiplinar;
 - integrimin e njohurive, trajtimin e çështjeve të ndërlikuara dhe gjykimin në kontekstin e mungesës së informacionit të plotë;
 - aftësinë intelektuale për të kritikuar apo mbrojtur zgjidhjet e problemit/eve.
- c. Kompetenca të tjera mund të përfshijnë: a) aftësinë për të integruar teknologjinë e informacionit dhe komunikimit në kërkimet gjuhësore, letrare e kulturore, siç është, për shembull, përdorimi i korpuseve gjuhësore dhe i softeve për kryerjen e analizave sasiore të tyre; b) aftësinë për t'u integruar në veprimtari mësimdhënëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

**KREU 2
ORGANIZIMI I STUDIMEVE TË DOKTORATËS**

**Neni 6
Programi i studimit të doktoratës**

1. Programi i studimit “Doktoratë” në “Studime gjuhësore, letrare e kulturore” është një program me natyrë ndërdisiplinare, i cili i përket fushës të gjerë të shkencave humane, sipas standardeve ndërkombëtare (fusha 6 sipas klasifikimit në Manualin e FRASCATI-t apo 0288 në klasifikimin ISCED), dhe ngërthen fusha si: përvetësim i gjuhës, gjuhësi dhe letërsi, dhe fusha e nënfusha më specifike të lidhura me to, si: sociolinguistikë, dialektologji, psikolinguistikë, gjuhësi kompjuterike, gjuhësi e krahasuar, gjuhësi e zbatuar, pragmatikë, semantikë, analizë diskursi, teori e letërsisë dhe kulturës, letërsi e vendeve/ në gjuhë të ndryshme, letërsi e krahasuar, studime kulturore, komunikim ndërkulturor, didaktikë dhe mësimdhënie e gjuhës, përkthim dhe interpretim etj.
2. Organizimi i programit të studimit doktoratë, kriteret e pranimit, personeli akademik i programit të Doktoraturës, kriteret dhe procedurat për fitimin e gradës shkencore “Doktor”, dhe të gjitha procedurat për zhvillimin e këtij programi, kryhen në Përputhje me rregulloren e Përgjithshme të UV-së, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Humane në UV si edhe rregulloren e Programit të Studimit të Ciklit të tretë Doktoratë në “ Studime gjuhësore letrare e kulturore”.
3. Grupet mësimore me karakter kërkimor-shkencor të Departmentit të Gjuhëve të Huaja dhe Departmentit të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë përfshihen në mënyrë të mëvetësishme ose në bashkëpunim me grupet e tjera brenda/jashtë njësisë ku bëjnë pjesë në procesin e hartimit, shkrimit dhe aplikimit të projekteve kërkimore-shkencore dhe zhvillimore për të siguruar financim me fonde kombëtare ose ndërkombëtare për zbatimin e tyre. Organizimi dhe drejtimi i studimeve të doktoratës kryhet në bashkëpunim me njëra-tjetrën. Termat e bashkëpunimit dhe përgjegjësitë e njësive bashkëpunuese përcaktohen në akt-marrëveshje të posaçme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

4. 1. Në bazë të numrit të projekteve kërkimore-shkencore dhe zhvillimore që këto njësi ndjekin, përcaktojnë:
- fushat/ nënfushat e kërkimit që lidhen me projektin/projektet që do të zbatohen dhe për të cilat kandidatët për doktorantë do të paraqesin projektpropozimet për t'u pranuar në programin e doktoratës;
 - numrin e studentëve doktorantë që do të pranohen në programin e studimit të doktoratës dhe ia përcjellin për miratim paraparak Komisionit të Dhënies së Gradës Doktor, i cili ia përcjell Senatit Akademik për miratim përfundimtar.
 - Senati Akademik i UV-së pas marrjes së vendimit për miratimin e kuotave deklaron numrin e doktorantëve.
2. Bazuar në fushat/nënfushat e përcaktuara nga njësia bazë organizohen edhe studimet e doktoratës, të cilat përmbajnë veprimtari kërkimore-shkencore që kontribuojnë në thellimin e studimit në këto fusha/nënfusha, me qëllim garantimin e formimit të doktorantëve.
5. Projekti kërkimor i çdo doktoranti përcaktohet në varësi të projekteve kërkimore që ndjekin Departamenti i Gjuhëve të Huaja dhe Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë.
6. Në funksion të realizimit të tij bashkërendohet edhe programi individual i doktorantit, i cili ngërthen veprimtari kërkimore-shkencore dhe krijuese, si bazë për përgatitjen e tezës së doktoratës (disertacionit), e nevojshme për marrjen e gradës shkencore "Doktor".

Neni 7

Kohëzgjatja e studimeve

- Koha normale e kohëzgjatjes së studimeve të doktoratës është 3 (tre) vite akademike.
- Kohëzgjatja maksimale e studimeve të doktoratës është 5 (pesë) vite akademike.
- Në raste të jashtëzakonshme, me kërkesë të studentit, Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", përjashtimisht, mund të marrë vendim për shtyrjen ose pezullimin e studimeve të doktoratës vetëm një herë, për një kohëzgjatje deri në 2 (dy) vjet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

Neni 8

Programi individual për aftësim të pavarur të doktorantit

1. Programi individual për aftësim të pavarur të doktorantit ndërtohet dhe zhvillohet sipas planit vjetor të programit të studimit të doktoratës bazuar në projektin kërkimor-shkencor dhe zhvillimit të financuar të njësisë/ve bazë.
2. Kur programi i studimit të doktoratës zhvillohet me kohë të plotë, sipas kohëzgjatjes normale të studimit nga 3 deri në 5 vite, programi individual për aftësim të pavarur të doktorantit realizohet sipas veprimtarive të kombinuara, të shtrira në kohë si vijon:

A. Veprimtaritë gjatë vitit të parë të studimeve	
Semestri i parë	Semestri i dytë
Pjesëmarrje në trajtime, ëorkshop-e, leksione të hapura për studentë të doktoratës nga profesorë vendas dhe të huaj, që lidhen me: a. metodologjinë e kërkimit në shkenca gjuhësore, letrare e kulturore, b. mësimdhënien e gjuhës, letërsisë e kulturës, të organizuara nga njësitë përgjegjëse ose nga IAL të tjera dhe/ose në bashkëpunim me to.	1. Vlerësim dhe miratim i planit të doktoratës 2. Studim i literaturës që lidhet me temën e disertacionit 3. Pjesëmarrje në leksione të hapura për studentë të doktoratës nga profesorë vendas dhe të huaj, që lidhen me këto fusha/nënfisha dhe tematika të mundshme për projektin kërkimor-shkencor dhe zhvillimor të njësisë/ve bazë: - Teori e letërsisë dhe kulturës - Letërsi në gjuhën angleze/gjuhën italiane/shqipe/botërore - Letërsi e krahasuar - Multikulturalizmi dhe ndërkulturaliteti - Gjuhësi e aplikuar - Studime britanike/amerikane/italiane/shqiptare - Shkencat humane digjitale - Kulturë britanike/amerikane/anglishtfolëse/italiane/shqipe - Politikat gjuhësore dhe sociolinguistika - Ndërtimi i korpuseve gjuhësore - Analizë kritike diskursi - Çështje të sotme të përkthimit - Etj.
Raportim 1 - Raportim për veprimtarinë e kryer gjatë vitit të parë të studimeve	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

B. Veprimtaritë gjatë gjithë pjesës tjetër të kohëzgjatjes së studimeve	
- Studim i literaturës që lidhet me temën e disertacionit - Publikime artikujsh, raportesh kërkimore (sipas fushës së përcaktuar të studimit) - Pjesëmarrje në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) - Angazhim në mësimdhënie - Mobilitet kërkimi (në rast se është e mundur brenda kuadrit të marrëveshjeve të njësisë/ve bazë)	- Punë kërkimore-shkencore - Shkrimi i kapitujve të parë
Raportim 2 - Raportim për veprimtarinë e kryer gjatë vitit të dytë/në vijim të studimeve	
C. Veprimtaritë gjatë gjithë pjesës tjetër të kohëzgjatjes së studimeve	
Paraqitje e rezultateve të punës kërkimore pranë grupit kërkimor të projektit të njësisë/ve bazë - Botime dhe publikime - Pjesëmarrje në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres)	- Disertacioni i doktoratës - Miratimi nga udhëheqësi
Dorëzimi i dosjes dhe mbrojtja e disertacionit	
Marrja e gradës shkencore "Doktor"	

3. Kur programet e studimit të doktoratës zhvillohen me kohë të zgjatur, sipas kohëzgjatjes normale të studimit 5 vite, programi individual për aftësim të pavarur të doktorantit realizohet sipas veprimtarive të kombinuara, të shtrira në kohë si vijon:

A. Veprimtaritë gjatë vitit të parë të studimeve	
Semestri i parë	Semestri i dytë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

Pjesëmarrje në trajtime, ërkshop-e, leksione të hapura për studentë të doktoratës nga profesorë vendas dhe të huaj, që lidhen me: c. metodologjinë e kërkimit në shkenca gjuhësore, letrare e kulturore, d. mësimdhënien e gjuhës, letërsisë e kulturës, të organizuara nga njësitë përgjegjëse ose nga IAL të tjera dhe/ose në bashkëpunim me to.	1. Vlerësim dhe miratim i planit të doktoratës 2. Studim i literaturës që lidhet me temën e disertacionit 3. Pjesëmarrje në leksione të hapura për studentë të doktoratës nga profesorë vendas dhe të huaj, që lidhen me këto fusha/nënfusha dhe tematika të mundshme për projektin kërkimor-shkencor dhe zhvillimor të njësisë/ve bazë: - Teori e letërsisë dhe kulturës - Letërsi në gjuhën angleze/gjuhën italiane/shqipe/botërore - Letërsi e krahasuar - Multikulturalizmi dhe ndërkulturaliteti - Gjuhësi e aplikuar - Studime britanike/amerikane/italiane/shqiptare - Shkencat humane digjitale - Kulturë britanike/amerikane/anglishtfolëse/italiane/shqipe - Politikat gjuhësore dhe sociolinguistika - Ndërtimi i korpuseve gjuhësore - Analizë kritike diskursi - Çështje të sotme të përkthimit - Etj.
Raportim 1 - Raportim për veprimtarinë e kryer gjatë vitit të parë të studimeve	
B. Veprimtaritë gjatë vitit të dytë të studimeve	
Semestri i parë	Semestri i dytë
Pjesëmarrje në leksione të hapura për studentë të doktoratës nga profesorë vendas dhe të huaj, që lidhen me këto fusha/nënfusha të mundshme për projektin kërkimor-shkencor dhe zhvillimor të njësisë/ve bazë: - Teori e letërsisë dhe kulturës - Letërsi në gjuhën angleze/gjuhën italiane/shqipe/botërore - Letërsi e krahasuar - Multikulturalizmi dhe ndërkulturaliteti - Gjuhësi e aplikuar - Studime britanike/amerikane/italiane/shqiptare - Shkencat humane digjitale	-Publikime artikujsh, raportesh kërkimore (sipas fushës së përcaktuar të studimit) -Pjesëmarrje në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) -Angazhim në mësimdhënie -Mobilitet kërkimi (në rast se është e mundur brenda kuadrit të marrëveshjeve të njësisë/ve bazë)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

- Kulturë britanike/amerikane/anglishtfolëse/italiane/shqipe - Politikat gjuhësore dhe sociolinguistika - Ndërtimi i korpuseve gjuhësore - Analizë kritike diskursi - Çështje të sotme të përkthimit	
Studim i literaturës që lidhet me temën e disertacionit	
C. Veprimtaritë gjatë gjatë vitit të tretë të studimeve	
- Punë kërkimore-shkencore - Shkrimi i kapitujve të parë	
Raportim 2 - Raportim për veprimtarinë e kryer në vijim të studimeve	
D. Veprimtaritë gjatë gjatë vitit të katërt të studimeve	
Paraqitje e rezultateve të punës kërkimore pranë grupit kërkimor të projektit të njësisë/ve bazë	-Botime dhe publikime -Pjesëmarrje në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres)
E. Veprimtaritë gjatë gjatë vitit të pestë të studimeve	
-Disertacioni i doktoratës -Miratimi nga udhëheqësi	
Dorëzimi i dosjes dhe mbrojtja e disertacionit	
Marrja e gradës shkencore "Doktor"	

4. Plani doktoral miratohet nga njësia bazë që ndjek projektin kërkimor. Në rastin kur projekti ndiqet nga të dyja njësitë, miratimi bëhet nga të dyja njësitë bazë.

5. Bazuar në planin doktoral të miratuar nga njësia/të bazë, doktoranti ndërton programin e tij individual për t'u aftësuar për kërkim të pavarur dhe përmbushje të kërkesave të programit të doktoratës, në përmbushje të këtyre aktiviteteve hulumtuese:

a. Të ketë ndjekur trajnim akademik të organizuar të përbërë nga leksione të posaçme të ofruara nga personel akademik i njësisë/ve bazë përgjegjëse të programit dhe/ose i ftuar nga IAL të tjera vendase dhe/ose të huaja, të realizuara kryesisht në kuadër të programeve të mobilitetit bazuar në marrëveshjet ndërinstucionale që fakulteti/UV ka lidhur, në fusha/nënfusha që lidhen me objektin e studimit për temën e disertacionit;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

- b. Të angazhohet në grupin kërkimor të përfshirë në projektin kërkimor-shkencor dhe/ose zhvillimor të njësisë bazë;
- c. Të ketë realizuar 2 (dy) prezantime publike të ecures së punimit të doktoratës dhe dy raportime vjetore në lidhje me ecurinë dhe vazhdimin e punës për zhvillimin e projektit kërkimor;
- d. Të ketë realizuar si autor i parë ose i dytë, kur autori i parë është udhëheqësi shkencor, së paku 3 (tre) referime, 2 (dy) nga të cilat të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN; apo cdo ndryshimi sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, në momentin e fitimit të statusit të doktorantit (neni 79, i rregullores së UV-së).
- e. Të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore, nga të cilët 2 (dy) të jenë botuar ose pranuar për botim në revista të indeksuara të vendeve të OECD-së, BE-së ose G20-ës, me bord editorial, ku, së paku, në njërin prej tyre të jetë autor i parë dhe në tjetrin autor i dytë dhe 1 (një) të jetë botuar ose pranuar për botim në revista shkencore të rankuara në *Journal Citation Reports* ose *Scopus*, ku është së paku autor i dytë.
- f. Të ketë përfunduar temën e doktoratës sipas rregullave të paraqitjes dhe stilit të punimeve të përcaktuara në këtë rregullore dhe në respekt të parimeve të etikës në kërkim dhe botime shkencore.
6. Përveç veprimtarive të mësipërme, doktorantët, në funksion të aftësimit të pavarur në fushën/nënfushën e studimit të doktoratës, angazhohen në:
- a. në programe mobiliteti në funksion të shkëmbimit të përvojës kërkimore me studentë doktrate nga universitete partnere;
- b. pjesëmarrjen në aktivitete didaktike, mësimdhënëse pranë njësive bazë përgjegjëse për programin.
7. Kur fushat e kërkimit janë të ndërthurura ndërmjet të dyja njësive bazë, njëra prej tyre caktohet përgjegjëse për ofrimin e programit të kërkimit të kandidatit, në dakordësi ndërmjet tyre.
8. Në përfundim të programit të doktoratës, doktoranti dorëzon pranë dekanit disertacionin e përfunduar së bashku me dosjen, e cila përmban dëshmi të plotësimit të elementeve të mësipërm të programit. Dekani i përcjell dosjen njësisë bazë për të vijuar me procedurat për mbrojtjen dhe vlerësimin e doktorantit. Dosja e doktorantit, përveç dokumentacionit ligjor të kërkuar dhe të përditësuar, vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve financiare, para mbrojtjes, duhet të përmbajë 5 kopje të printura të disertacionit (temës) të firmosura nga doktoranti dhe udhëheqësi shkencor, 2 kopje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

elektronike të saj, në formatin pdf, për procedurat e mëtejshme të mbrojtjes, 10 autoreferate me një përmbledhje të punimit (në format A 5), në gjuhën shqipe dhe 5 autoreferate me përmbledhje të punimit në (format A 5), në gjuhë angleze.

Neni 9

Strukturat akademike dhe organet përgjegjëse për studimet e doktoratës

1. Grupimi i njësive: Departamenti i Gjuhëve të Huaja në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, Fakulteti i Shkencave Humane, është përgjegjës për ofrimin, organizimin dhe drejtimin e programit “Doktoratë” në “Studime gjuhësore, letrare e kulturore”. Termat e bashkëpunimit dhe përgjegjësitë e secilës njësi bashkëpunuese janë përcaktuar në akt-marrëveshjen e posaçme.
2. Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” (në vijim: komisioni) është përgjegjës për vlerësimin përfundimtar të dosjes së kandidatëve për doktorantë, ngritjen e komisionit të mbrojtjes së disertacionit, vlerësimin për përmbushjen e detyrimeve të programit nga doktoranti dhe vendimin për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.
3. Juria për mbrojtjen e gradës shkencore “doktor” (në vijim: komisioni) është përgjegjëse për vlerësimin e disertacionit.
4. Koordinator i programit të studimit të doktoratës është përgjegjës për ndjekjen e programit të doktoratës.
5. Përgjegjësi i programit të studimit të doktoratës është përgjegjës për ndjekjen e programit të doktoratës në nivel njësie kryesore.
6. Drejtuesi shkencor (në vijim: udhëheqësi) është personel akademik, pranë njërës prej njësive përgjegjëse për programin ose i ftuar nga një IAL tjetër në vend ose jashtë, i cili ndjek, mbikëqyr dhe udhëzon doktorantin për realizimin e temës së doktoratës. Udhëheqja mund të kryhet edhe nga më shumë se një personel akademik në bashkëudhëqje me njëri-tjetrin, sipas një kontrate tip të hartuar në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi (neni 78, pika 13- a, b dhe c e Rregullores së UV-së). Drejtuesi shkencor (në vijim: udhëheqësi) është personel akademik, pranë njërës prej njësive



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE SENATI AKADEMIK

përgjegjëse për programin ose i ftuar nga një IAL tjetër në vend ose jashtë, i cili ndjek, mbikëqyr dhe udhëzon doktorantin për realizimin e temës së doktoratës. Udhëheqja mund të kryhet edhe nga më shumë se një personel akademik në bashkëudhëqje me njëri-tjetrin, sipas një kontrate tip të hartuar në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi (neni 78, pika 13- a, b dhe c e Rregullores së UV-së). Bashkëudhëqësi shkencor i studentit doktorant miratohet nga njësitë bazë përgjegjëse për studimet doktorale. Nevoja për bashkëudhëqës duhet të jetë e argumentuar dhe lejohet vetëm në raste të karakterit të theksuar ndërdisiplinar të tezës së disertacionit! Statusi, veprimtaria dhe marrëdhëniet e tij me UV bazohen dhe zhvillohen në përputhje me këtë rregullore dhe aktet e brendshme të UV. Nuk lejohet me shumë se një bashkëudhëqës për të njëjtën tezë doktorale. Oponenti është anëtar i jurisë i cili bën vlerësimin e temës së doktoratës në kuptimin e përmbushjes së kriterëve formale të paraqitjes së punimit, origjinalitetit, metodologjisë së ndjekur, gjetjet, rëndësisë.

7. Nuk lejohet më shumë se një bashkëudhëqës për të njëjtën tezë doktorale. Oponenti është anëtar i jurisë i cili bën vlerësimin e temës së doktoratës në kuptimin e përmbushjes së kriterëve formale të paraqitjes së punimit, origjinalitetit, metodologjisë së ndjekur, gjetjet, rëndësisë.

8. Komisioni *ad-hoc* për shqyrtimin e dosjeve të kandidatëve për doktorantë, i cili përbëhet nga personel akademik i kategorisë “Profesor” i njësisë/ve bazë përgjegjëse për programin, është përgjegjës për marrjen në shqyrtim të dosjeve, vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve.

9. Sekretari i Studimeve të Doktoratës është përgjegjës për komunikimin dhe administrimin zyrtar të të gjithë dokumentacionit të procedurës nga faza e aplikimit të doktorantit, deri në arkivimin e dosjes së tij, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

10. Relatori kontrollon çdo dokument të depozituar në dosje, sipas kriterëve të përcaktuara nga ligji, shqyrton anën procedurale të hartimit të dosjes, kontrollon dhe vërteton saktësinë e dokumentacionit të depozituar në dosje, në rast të kundërt, kërkon saktësimin, plotësimin apo zëvendësimin e tij. Relatori harton relacionin përfundimtar, e nënshkruan atë dhe e paraqet brenda afateve të parashikuara në rregullore dhe aktet e tjera nënligjore. (Neni 15, Rregullore e KDGF të FSHH-së)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

Neni 10

Kriteret e pranimit

1. Kriteret dhe kuotat e pranimit përcaktohen paraprakisht nga njësitë bazë, që janë përgjegjëse për përcaktimin e këtyre kriterëve që ofrojnë programin e doktoratës në vendimmarrje të përbashkët, i përcillen, për miratim të mëtejshëm Komisionit të Dhënies së Gradës “Doktor” të FSHH-së, i cili ia përcjell Senatit Akademik për miratim përfundimtar.
2. Për t’u pranuar në programin e doktoraturës, kandidati duhet të përmbushë kriteret themelore të pranimit si më poshtë vijon:
 - a. të zotërojë diplomë të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave”, diplomë të integruar të studimeve të ciklit të dytë ose çdo diplomë tjetër të vlerësuar të barazvlefshme me të, diplomë të fituar jashtë vendit të njohur dhe të njësuar nga organet kompetente, në fushat/nënfushat e mëposhtme të studimit:
 - studime letrare;
 - gjuhësi;
 - mësimdhënie e gjuhës së huaj (angleze, italiane, etj);
 - mësimdhënie e gjuhës shqipe dhe letërsisë;
 - përkthim dhe interpretim;
 - komunikim (ndërkulturor).
 - fusha/nënfusha të tjera filologjike/humane që lidhen me studimin e gjuhës, letërsisë e kulturës/ave;
 - b. të ketë notë mesatare të paktën 8 (tetë) në çdo diplomë që zotëron, të lëshuar nga IAL shqiptare apo të huaja;
 - c. në rast numër të barabartë kandidatësh, prioritet u jepet kandidatëve që kanë ndjekur programet e studimit “Master i shkencave” pranë Departmentit të Gjuhëve të Huaja dhe Departmentit të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, Fakulteti i Shkencave Humane, UV;
 - d. nëse numri i kandidatëve është sërish i barabartë, prioritarë do të jenë kandidatët që janë anëtarë të personelit akademik të këtyre njësive;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

- e. të zotërojë një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht dhe italisht), niveli B2, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit, përgjegjës për arsimin e lartë, nr.10, datë 16.06.2023, për “ Një ndryshim në udhëzimin nr. 52, datë 03.12.2015, “ Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë. Ky kriter është i vlefshëm për kandidatë, që kanë fituar një diplomë të një programi studimi, që nuk është kryer në një nga këto gjuhë;
- f. të dëshmojë pjesëmarrje në aktivitete mësimdhënëse universitare dhe shkencore (konferenca, seminare, kongrese, simpoziume) dhe publikime në fushat/nënfishat e programit të doktoratës;
- g. të ketë hartuar projektpropozimin sipas kërkesave në shtojcën 1 në Rregulloren për organizimin e ciklit të tretë të studimeve (doktoratë) në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë.
- h. të plotësojë kriteret të tjera shtesë të propozuara nga njësitë bazë dhe të miratuara nga Senati Akademik.
3. Kuotat e pranimi propozohen nga njësitë bazë përgjegjëse për programin dhe miratohen nga Senati Akademik. Numri maksimal i kuotave të propozuara përmbledh numrin e kuotave të propozuara për të gjitha projektet kërkimore dhe zhvillimore që njësitë bazë ndjekin. Numri maksimal i kandidatëve për projekt është 3 (tre) (neni 78,79, i Rregullores së UV-së).

Neni 11

Procedura e aplikimit dhe regjistrimit të kandidatëve

1. Për të aplikuar, kandidati dorëzon pranë protokoll-arkivit të fakultetit dosjen me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. Formulari tip i aplikimit (që merret pranë zyrës së protokoll-arkivës së fakultetit);
 - b. Çertifikatë personale në origjinal (me 2 mbiemra)
 - c. Kopje të dokumentit identifikues (pasaportë/kartë identiteti);



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

- ç. Fotokopje të noterizuar të diplomave të fituara në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve. Diplomat e fituara në universitete jashtë vendit duhet të jenë të njësuara. Dokumenti i njësimit i lëshuar nga ministria përkatëse për arsimin duhet të shoqërojë këto diploma;
- d. Listën e notave për secilin program studimi të kryer (cikli i parë dhe cikli i dytë);
- e. Curriculum vitae (CV);
- f. Dëshmi të gjuhës së huaj të mbrojtur sipas përcaktimeve të nenit 10, pikën 2, e, më sipër;
- g. Dëshmi dhe vërtetime që lidhen me kualifikime, trajnime të mëtejshme, publikime, pjesëmarrje në aktivitete shkencore në fushën/nënfushën e studimit të programit të doktoratës;
- h. Dy rekomandime nga personel akademik i kategorisë “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”.
- i. Projektpropozimi për temën e doktoratës, hartuar sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, bashkëlidhur kësaj rregullore.
- j. Deklaratë personale për përmballimin e shpenzimeve të programit të doktoratës, në rast vetëfinancimi;
- k. Deklaratë e udhëheqësit shkencor për angazhim në udhëheqje të kandidatit;
- l. Vërtetim pune, nëse ka;
- m. Mandat-pagesën për tarifën e aplikimit;
2. Pas marrjes në dorëzim të dokumentacionit, aplikantit i lëshohet vërtetim për marrjen në dorëzim të dosjes. Protokoll-arkivi i fakultetit ia përcjell listën e aplikuesve së bashku me dosjet e aplikimeve të protokolluara përgjegjësit të programit të studimit të doktoratës (zëvendësdekanit për anën shkencore nëpërmjet sekretarit të doktoratës), i cili njofton zyrtarisht njësitë bazë përgjegjëse të programit, për marrjen në dorëzim të tyre.
3. Njësitë bazë përgjegjëse ngrenë komisionin *ad-hoc* të përbashkët për shqyrtimin e aplikimeve, përbërja e të cilit miratohet nga dekani.
4. Dosjet e aplikimit të kandidatëve i përcillen zyrtarisht komisionit *ad-hoc* për shqyrtim, nga njësitë bazë përgjegjëse.
5. Pas shqyrtimit të dosjeve të kandidatëve, verifikimit të përmbushjes së kritereve themelore, vlerësimit të projekt-propozimit të disertacionit dhe dokumentacionit të paraqitur, në mënyrë transparente, cilësore dhe sasiore, sipas një skeme vlerësimi të parapërcaktuar dhe të miratuar paraprakisht nga anëtarët e komisionit *ad-hoc*, komisioni *ad-hoc* bën përzgjedhjen e kandidatëve dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

i përcjell njësisë/ve bazë listën e kandidatëve të përzgjedhur për miratimin përfundimtar në mbledhjen e kësaj/këtyre të fundit.

6. Brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e fituesve në sekretari dhe këndin zyrtar të njoftimeve të fakultetit, kandidati ka të drejtën e ankimit ndaj vendimit për shpalljen e kandidatëve fitues. Kërkesat e ankimit trajtohen nga një komision i posaçëm me 3 (tre) anëtarë nga kategoria “profesor”, i propozuar nga njësitë bazë dhe i miratuar nga dekan. Pas përfundimit të afatit të ankimit, lista përfundimtare e fituesve i përcillet dekanit të fakultetit, i cili ia përcjell mandej rektorit.

7. Në rastet kur kandidati, për arsye objektive, vendos ta ndryshojë temën e punimit të doktoratës, i nënshtrohet procedurës së njëjtë për miratimin e temës së punimit të doktoratës.

8. Vendimi për ndryshimin e temës vendoset në dosjen e kandidatit.

Neni 12

Financimi

1. Vlera financiare e doktoratës planifikohet dhe mbulohet nga fondet për kërkimin shkencor të Fakultetit të Shkencave Humane që ofron programin dhe/ose nga grantet e punës kërkimore-shkencore që financohen nga buxheti i shtetit sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, nga institucione të tjera financuese, burime të tjera publike dhe jopublike.

2. Për kryerjen e studimeve të doktoratës, studenti mund të vetëfinancohet. Formulari tip i vetëfinancimit, merret pranë zyrës së protokoll-arkivës së fakultetit.

3. Tarifa e studimit përcaktohet me vendim të Bordit të Administrimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

KREU 3

PËRGJEGJËSITË NË PROCESIN E REALIZIMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS

Neni 13

Të drejtat dhe detyrat e doktorantit

1. Doktoranti ka të drejtë të:

- a. aftësohet për programin e doktoratës duke marrë akses në bibliotekën e UV-së, fizike dhe online, bibliotekat e fakultetit, në arkivat dhe të gjitha databazat ku UV është e pajtuar;
- b. shfrytëzojë mjediset kërkimore-shkencore (qendrën kërkimore dhe laboratorët e fakultetit) për qëllime hulumtimi pas pajisjes me një leje paraprake për shfrytëzimin e tyre të lëshuar nga dekani i fakultetit;
- c. informohet për aktet ligjore dhe nënligjore dhe ndryshimet që mund të pësojnë, që rregullojnë organizimin dhe realizimin e studimeve të doktoratës dhe marrjen e gradës shkencore “doktor”;
- d. marrë pjesë në aktivitetet kërkimore-shkencore të njësive bazë/kryesore dhe të përfitojë nga mundësitë e shkëmbimit që lidhen me objektin e tij/saj të kërkimit.
- e. të transferojë studimet e doktoratës sipas nenit 85 të rregullores në fuqi të UV-së, apo t'i pezullojë ato, sipas nenit 108, të po kësaj rregulloreje dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- ë. të pajiset me Diplomën e Gradës Shkencore “Doktor”, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Doktoranti ka këto detyrime:

- a. Të respektojë programin e miratuar të doktoratës;
- b. Të përmbushë detyrimet akademike e financiare të programit të studimit të doktoratës;
- c. Të njihet me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe realizimin e studimeve të doktoratës dhe marrjen e gradës shkencore “Doktor” dhe përditësohet me ndryshimet e mundshme që mund të pësojnë;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

d. Të respektojë rregullat e etikës në kërkim gjatë procesit të hulumtimit dhe ato të integritetit akademik gjatë procesit të hartimit të disertacionit;

e. Të raportojë rregullisht për ecurinë dhe vazhdimin e punës për zhvillimin e projektit kërkimor;

f. Të respektojë afatet ligjore për raportimet vjetore, përfundimin e disertacionit dhe dorëzimit të dosjes për përmbylljen e programit të doktoratës nga 3-5 vjet.

3. Statusi i kandidatit/doktorantit fillon nga data e vendimit përfundimtar të Senatit Akademik për miratimin e kërkesës së tij dhe dërgimit për regjistrim/matrikullim në QSHA dhe përfundon me Vendimin e Komisionit të Dhënies së Gradës Shkencore "Doktor" të FSHH-së, dhe i nënshtrohet akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi nga momentit e fitimit të statusit të kandidatit/doktorantit deri në përfundimin e tij. Në rast se kandidati/doktoranti në përfundim të afatit 3-vjeçar të kohëzgjatjes normale të studimeve doktorale, për arsye objektive, nuk i ka përmbushur kriteret ligjore për dorëzimin e dosjes pranë zyrës së dekanit, mund t'i drejtohet njësisë bazë dhe Komisionit të Dhënies së Gradës Shkencore "Doktor" të FSHH-së, me një kërkesë për zgjatjen e afateve të studimeve të doktoratës, të cilën, Komisioni i Dhënies së Gradës Shkencore "Doktor" të FSHH, e miraton ose e refuzon nëpërmjet vendimit përkatës, duke përcaktuar edhe afatin e kohëzgjatjes.

Pas përcjelljes së dosjes së doktorantit për mbrojtje nga Dekani në departament, Komisioni ad Hoc i departamentit/departamenteve dhe relatori i dosjes që është anëtar i Komisionit të Doktoratës, do ta vlerësojnë dosjen e doktorantit në relacionet përkatëse, duke u bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat kanë qenë në fuqi, në momentin e fitimit të statusit të doktorantit, pra pas vendimit të miratimit përfundimtar nga senati akademik të temës së disertacionit dhe të udhëheqësit/bashkë-udhëheqësve shkencorë dhe përcjelljes së tij në instancat përkatëse.

Neni 14

Roli dhe përgjegjësitë e drejtuesit shkencor

1. Drejtuesit shkencorë (në vijim: udhëheqësit) të doktorantëve duhet të kenë titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar" dhe mund të udhëheqin, respektivisht:

a) jo më shumë se 3 (tre) kandidatë/doktorantë njëkohësisht, në rastin e personelit akademik që mban



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

titullin “Profesor”, ku përfshihen të gjitha udhëheqjet që personeli akademik ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë ku ai është i angazhuar, brenda ose jashtë vendit, ku përfshihen edhe bashkëudhëheqjet;

b) jo më shumë se 2 (dy) njëkohësisht, në rastin e personelit akademik që mban titullin “Profesor i Asociuar”, ku përfshihen të gjitha udhëheqjet që personeli akademik ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë ku ai është i angazhuar, brenda ose jashtë vendit, ku përfshihen edhe bashkëudhëheqjet;

2. Udhëheqësi ka për detyrë:

a) Të përcaktojë temën e doktoratës dhe metodologjinë e kërkimit për të realizuar projektin kërkimor.

b) Të hartojë në bashkëpunim me doktorantin planin e punës për realizimin e temës së disertacionit.

c) Të lehtësojë aksesin në burime kërkimore, literaturë, ekspertizë, organizim të punës në terren.

d) Të këshillojë për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve teknike, përmes dhënies dhe sugjerimit të alternativa.

e) Të mbajë rregullisht takime me doktorantin për të ndjekur nga afër progresin me projektin kërkimor të doktoratës.

f) Të japë mendime dhe sugjerime në lidhje me ecurinë për realizimin e temës së disertacionit duke vlerësuar metodologjinë për mbledhjen e të dhënave, draft- kapitujt, literaturën e përdorur për studimin, interpretimin e të dhënave, përfundimet.

g) Të nxisë mendimin e pavarur dhe ndihmojë doktorantin të përvetësojë dhe marrë vendime në lidhje me punën kërkimore për realizimin e temës së doktoratës.

h) Të mbështesë, inkurajë e tregojë interes, si dhe diskutojë idetë e doktorantit.

i) Të kontrollojë rregullisht ecurinë e studimit sipas planifikimit të kryer.

j) Të miratojë disertacionin përpara dorëzimit dhe të hartojë një raport vlerësues të argumentuar për punimin e doktorantit, për tu prezantuar para njësisë bazë dhe komisionit për dhënien e gradës “Doktor”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

2. Në rastet e bashkëudhëheqjes, detyrat dhe përgjegjësitë e secilit udhëheqës duhet të specifikohen paraprakisht. Në këto raste, përpilohet dhe dakordësohet një marrëveshje tip ndërmjet doktorantit dhe bashkëudhëheqësve.

3.a) Për arsye objektive dhe të jashtëzakonshme, udhëheqësi mund të ndërrohet. Në këtë rast, doktoranti i drejtohet njësisë bazë që mbulon programin e tij individual me një kërkesë ku shpjegon arsyet e kërkesës. Drejtuesi i njësisë bazë ia përcjell kërkesën komisionit ad-hoc që ka vlerësuar kandidatët. Komisioni ad-hoc merr në shqyrtim kërkesën dhe, në rast se e gjykon kërkesën të arsyeshme, cakton udhëheqësin e ri. Në rast se kërkesa vjen nga drejtuesi shkencor, ndiqet e njëjta procedurë. Në përfundim të procedurës informohet zyrtarisht drejtuesi i njësisë kryesore dhe Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", dhe Dekani bën përpjelljen e këtyre ndryshimeve në instancat përkatëse.

b) Në rastet kur udhëheqësi shkencor jep dorëheqjen nga IAL, i ndërpriten marrëdhëniet aktive të punës me UV, nuk ka të drejtë të vijojë udhëheqjen e doktorantëve, pa një kontratë aktive pune me një IAL tjetër dhe pa një marrëveshje midis këtyre dy institucioneve për programet e ciklit të tretë, doktoratë, brenda ose jashtë vendit.

Neni 15

Përgjegjësitë e njësisë bazë

1. Njësia bazë, si struktura akademike ku zhvillohen studimet e doktoratës, është përgjegjëse për:

- a. organizimin dhe realizimin e të gjitha hapave të procesit të doktoratës;
- b. përcaktimin e fushave/nënfushave ku do të hartohet/n projekti/et kërkimore të njësisë bazë për zhvillimin e programit të doktoratës;
- c. propozimin e kuotave dhe kritereve të pranimit të studentëve të doktoratës, të cilat ia dërgon për miratim paraprak Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", i cili ia përcjell për miratimin përfundimtar Senatit Akademik;
- d. vlerësimin dhe miratimin e kandidatëve fitues për studentë të doktoratës;
- e. miratimin e udhëheqësve të punimeve të doktoratës;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE SENATI AKADEMIK

f. krijimin e kushteve dhe lehtësirave për doktorantët për realizimin e projektit kërkimor për temën e doktoratës, përmes vënies në dispozicion të kapaciteteve infrastrukturore të nevojshme, informimit dhe përditësimit të vazhduar në lidhje me kërkesat dhe afatet ligjore për përmbylljen e studimeve të doktoratës, çështjet formale për paraqitjen e punimeve, si dhe aspekte të tjera që lidhen me realizimin e programit të doktoratës;

g. sigurimin që doktoranti ka përmbushur kriteret dhe detyrimet akademike të programit dhe që tema e disertacionit ka kaluar kontrollin antiplagjiaturë, sipas Rregullores së UV-së dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, përpara përcjelljes tek Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”,

i. Harton dhe përditëson rregulloren e studimeve të doktoratës, të cilën ia dërgon për miratim paraprak Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, i cili ia përcjell për miratimin përfundimtar Senatit Akademik; (sipas nenit 78, pika 6, të Rregullores së UV-së 2025).

Neni 16

Roli dhe përgjegjësitë e komisionit ad-hoc për vlerësimin e kandidatëve për doktorantë

1. Komisioni ad-hoc për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve për doktorantë përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë të kategorisë “profesor” të njësive bazë përgjegjëse të programit të marra së bashku. Dy prej anëtarëve të komisionit janë përgjegjësit e njësive bazë që ofrojnë programin e studimit (Përrjashtim përbën rasti kur drejtuesi i njësisë bazë nuk i përket kategorisë “profesor”. Në këtë rast, komisioni plotësohet me një anëtar tjetër nga kjo kategori). Anëtarët e tjerë zgjidhen në mënyrë të tillë që të mbulojnë fushat/nënfishat e propozuara nga njësitet bazë. Përbërja e komisionit ad-hoc miratohet nga dekani.

2. Numri i anëtarëve që i përket secilës njësi bazë në komisionin ad-hoc përcaktohet mbi bazën e projektit kërkimor dhe/ose zhvillimor që ofron njësia. Njësia që ofron projektin kërkimor ka numrin më të madh të anëtarëve në përbërjen e komisionit ad-hoc. Ky numër nuk i kalon 3 (tre) anëtarë.

3. Në rastin kur projekti kërkimor-shkencor ofrohet nga të dyja njësitet, numri më i madh i anëtarëve i përket njësisë që ka numrin më të madh të personelit akademik nga kategoria “profesor”. Në rast se numri i profesorëve është i barabartë për të dyja njësitet, përfaqësimi në komisionin ad-hoc



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

dakordësohet nga njësitë bazë dhe miratohet nga dekani. Në çdo rast, ky numër nuk i kalon 3 (tre) anëtarë.

4. Pas marrjes në dorëzim të dosjeve të aplikantëve, komision ad-hoc kryen vlerësimin e tyre bazuar mbi një skedë vlerësimi të hartuar e dakordësuar paraprakisht nga gjithë anëtarët e komisionit ad-hoc.

5. Vlerësimi i dosjes bazohet në verifikimin e përmbushjes së kritereve themelore, vlerësimi të projekt-propozimit të disertacionit dhe dokumentacionit të paraqitur, në mënyrë transparente, cilësore dhe sasiore.

6. Komisioni ad-hoc gjithashtu cakton udhëheqësin, pasi ka marrë paraprakisht propozimin e kandidatit për doktorant (nëse ka) dhe mendimin/vlerësimin me shkrim/me gojë, të koordinatorit të programit të doktoratës. Për caktimin e udhëheqësit merren parasysh:

a. Projekti kërkimor-shkencor dhe/ose zhvillimor që personeli akademik i kategorisë “profesor” i propozuar për drejtues shkencor të kandidatit drejton;

b. Fusha/nënfusha e kërkimit, sipas natyrës së projektit, që mbulon personeli akademik i kategorisë “profesor” i propozuar për drejtues shkencor të kandidatit;

c. Numri i doktorantëve që ai/ajo udhëheq.

7. Komisioni ad-hoc bën përzgjedhjen e kandidatëve dhe i përcjell njësisë bazë listën e kandidatëve të përzgjedhur për miratim në mbledhjen e këtyre të fundit.

Neni 17

Roli dhe detyrat e përgjegjësit të programit të doktoratës

1. Zëvendëse dekani për kërkimin shkencor ndjek zbatimin e programit të doktoratës në nivelin e njësisë kryesore.

2. Ai ka për detyrë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

- a. Përcjelljen zyrtarisht të listës dhe dosjeve të aplikantëve pranë komisionit ad-hoc për vlerësimin e kandidatëve për doktorantë, pas marrjes në dorëzim nga zyra e protokoll-arkivës së fakultetit (FSHH-së).
- b. Sigurimin e zbatimit dhe respektimit nga ana e njësive bazë të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi që rregullon studimet e doktoratës për çështje që lidhen me kuotat dhe kriteret e pranimit, afatet e aplikimit për t'u pranuar në program, përzgjedhjen e kandidatëve fitues, përzgjedhjen e udhëheqësve në përputhje dhe përshtatje me fushën/nënfishën e projektit kërkimor dhe elementët e tjera të vlefshmërisë për të qenë drejtues shkencor, kohëzgjatjen e studimeve dhe ecurinë e programit individual të doktorantit.
- c. Mbikëqyrjen e efikasitetit dhe cilësisë së kapaciteteve infrastrukturore të njësisë kryesore në dispozicion të programit të doktoratës.
- d. Garantimin për informim të vazhduar të doktorantëve, njësive bazë dhe kandidatëve të interesuar për çështje që lidhen me programet e doktoratës dhe rregullat e aktet ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me to.
- e) Midis përgjegjësit të programit të studimit të doktoratës në nivel njësie kryesore dhe kandidatit të shpallur fitues, lidhet një kontratë tip.

Neni 18

Roli dhe detyrat e koordinators të programit të doktoratës

1. Koordinator i programit të doktoratës është personel akademik i kategorisë "Profesor" pranë njërës prej njësive përgjegjëse për programin dhe caktohet në dakordësi mes tyre në akt-marrëveshjen e grupimit të njësive. Në rast të pamundësisë së kryerjes së kësaj detyre nga ana e personelit akademik, për arsye madhore dhe vetjake (dorëheqje, shpërngulje nga puna, dalje në pension, ndarje nga jeta), procedura për caktimin e koordinators të ri është e njëjtë.
2. Detyrat e koordinators të programit të doktoratës përfshijnë:
- a. Të mbështesë dhe mbrojtë interesat e studentëve të doktoratës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

- b. Të këshillojë për çështjet e programit të doktoratës studentët e doktoratës, udhëheqësit e tyre dhe strukturat e tjera akademike që kanë lidhje me realizimin e programit të doktoratës.
- c. Të organizojë takime informuese apo kryejë informime të tjera të vazhduara për të siguruar e lehtësuar njohjen e studentëve të doktoraturës me projektet kërkimore të njësisë bazë, planin e punës për realizimin e projektit të tyre kërkimor, afatet për përmbushjen e detyrimeve akademike, të aftësimit dhe kërkimit në funksion të realizimit të temës së doktoratës dhe kritereve të tjera për plotësimin e dosjes për marrjen e gradës shkencore “doktor”.
- d. Të garantojë që çdo doktorant ka të përcaktuar qartë programin individual për aftësim të pavarur në kërkim shkencor në fushën/nënfushën e përcaktuar dhe ndiqet nga udhëheqës shkencor me ekspertizën e duhur në këtë fushë/nënfushë.
- e. Të koordinojë aktivitetet për aftësim të pavarur në kërkimin shkencor të doktorantit të organizuara nga njësi bazë.

Neni 19

Roli dhe përgjegjësitë e Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “doktor”

1. Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” është komision i përhershëm që ngrihet në Fakultetin e Shkencave Humane për të monitoruar procesin për dhënien e gradës shkencore “doktor”.
2. Ai përbëhet nga 5 (pesë), anëtarë të zgjedhur nga asambleja e personelit akademik të Fakultetit të Shkencave Humane, që kanë titullin akademik “profesor i asociuar” ose “profesor”.
3. Anëtarët e këtij komisioni kanë mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Vendi i mbetur vakant plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për këtë komision. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të komisionit, i cili do të ushtrojë detyrën për pjesën e mbetur të mandatit.
4. Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin përfundimtar të dosjes së kandidatit, pas vlerësimit paraprak nga njësi bazë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

5. Komisioni, nëse e vlerëson pozitivisht dosjen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve ngre jurinë për vlerësimin e disertacionit.

6. Pas prezantimit të disertacionit, juria e vlerëson atë dhe harton raportin e vlerësimit për t'ia dërguar më pas komisionit, i cili, brenda 10 (dhjetë) ditëve, merr vendimin për dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" dhe ia përcjell për procedura të mëtejshme drejtuesit të njësisë kryesore.

Neni 20

Ngritja, roli dhe funksionimi i jurisë për mbrojtjen e gradës shkencore "doktor"

1. Disertacioni prezantohet para jurisë për mbrojtjen e gradës shkencore "doktor", e cila ngrihet nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "doktor".

2. Ngritja e jurisë bëhet pasi kandidati ka përfunduar disertacionin dhe ka plotësuar të gjitha kriteret e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe përcaktimet në këtë rregullore.

3. Pasi ka hartuar disertacionin sipas formatit të miratuar në këtë rregullore (shtojca 1), kandidati dorëzon zyrtarisht disertacionin, së bashku me dosjen, pranë zyrës së protokollit të drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia përcjell zyrtarisht për vlerësim njësisë bazë që ndjek programin individual për aftësim të pavarur të doktorantit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e dorëzimit. Zyra e protokollit të fakultetit, përpilon dy procesverbale me përmbajtje dhe numër protokollit të njëjtë, të cilat pasi firmosen nga protokolluesi dhe kandidati që ka dorëzuar dosjen dhe disertacionin, një kopje e procesverbalit i jepet kandidatit dhe kopja tjetër bëhet pjesë e dosjes së kandidatit për procedurat e mëtejshme.

4. Pas vlerësimit nga njësia bazë të përmbushjes së kriterëve formale dhe kontrollit antiplagjiaturë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, procesverbali i të cilit është pjesë e dosjes së kandidatit, brenda 15 ditësh nga marrja e dosjes nga drejtuesi i njësisë kryesore, disertacioni dhe dosja e kandidatit i përcillen me shkresë zyrtare të protokolluar në protokollin e fakultetit, Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Komisioni, nëse e vlerëson pozitivisht dosjen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve ngre jurinë për vlerësimin e disertacionit.

5. Juria përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët, të paktën 2 (dy) anëtarë u përkasin njësive bazë nga institucione homologe, vendase ose të huaja. Anëtarët e jurisë propozohen nga njësiti bazë, dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

miratohen paraprakisht nga drejtuesi i njësisë kryesore, i cili ia përcjell zyrtarisht, për miratimin përfundimtar, Komisionit të Dhënies së Gradës Shkencore “Doktor”. Numri i anëtarëve të propozuar, të cilët i përkasin kategorisë “profesor”, është jo më pak se 8 (tetë). Dy anëtarë të jurisë caktohen oponentë për vlerësimin e disertacionit, njëri prej të cilëve i përket njësive bazë nga institucione homologe, vendase ose të huaja.

6. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga formimi i saj, juria cakton datën e mbrojtjes së disertacionit. Në rast se për arsye të jashtëzakonshme, njëri nga anëtarët e komisionit e ka të pamundur praninë në komision në datën e mbrojtjes së disertacionit, përgjegjësi i njësive bazë që ndjek programin individual për aftësim të pavarur të doktorantit vë në dijeni drejtuesin e njësive kryesore duke propozuar një datë të re për mbrojtjen. Drejtuesi i njësive kryesore ia përcjell propozimin Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “doktor”, i cili njofton jurinë. Juria, pas miratimit paraprak nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore “doktor”, merr vendim për datën e re. E njëjta procedurë ndiqet edhe në rastin kur doktoranti, për arsye të jashtëzakonshme, e ka të pamundur praninë në datën e caktuar për mbrojtjen e temës së doktoratës.

7. Pas paraqitjes së disertacionit, juria harton raportin e vlerësimit dhe ia dërgon Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, i cili, brenda 10 (dhjetë) ditëve, merr vendimin për dhënien e gradës shkencore “Doktor” dhe ia përcjell për procedura të mëtejshme drejtuesit të njësive kryesore.

8. Lista e të diplomuarve në programet e ciklit të tretë përcillet nga IAL-të në ministrinë përgjegjëse për arsimin, për t’u pasqyruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore e titujve akademikë dhe në regjistrat përkatës të IAL-së.

9. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë për dhënien e gradës shkencore “Doktor”, e nënshkruar nga drejtuesi i njësive kryesore dhe rektori.

10. Nëse njësia bazë ose Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” jep vlerësim negativ për disertacionin dhe/ose dosjen, kandidati ka të drejtë të riparaqesë disertacionin dhe/ose dosjen të plotësuar pas një periudhe jo më të shkurtër se 3 (tre) muaj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

Neni 21

Sigurimi i cilësisë

1. Njësitë bazë përgjegjëse për studimet e doktoratës janë të detyruara që të kujdesen për mbajtjen dhe ruajtjen e dokumentacionit që lidhet me studimet e doktoratës: procedurat, kriteret dhe kuotat e pranimit, planet individuale të doktorantëve, projektet kërkimore-shkencore dhe zhvillimore të njësisë bazë në funksion të programit të doktoratës, dosjet e doktorantëve, raportimet vjetore për ecurinë e doktorantëve, të dhëna sasiore për numrin e doktorantëve të regjistruar dhe numrin e doktorantëve të cilët e kanë mbrojtur punimin e doktoratës.
3. Njësitë bazë kryejnë procesin e vetëvlerësimit në bazë të këtij dokumentacioni.
4. Kriteret për vlerësim përfshijnë: produktin shkencor/artistik të mësimdhënësve/udhëheqësve dhe të doktorantëve, mësimdhënien, cilësinë e punimeve të doktoratës, treguesit statistikorë të kohëzgjatjes së studimeve, treguesit statistikorë të numrit vjetor të doktorëve të rinj në krahasim me numrin e doktorantëve, bashkëpunimet ndërkombëtare, kapacitetet infrastrukturore dhe akademike në dispozicion të programit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

**KREU 4
PËRMBYLLJA E STUDIMEVE TË DOKTORATËS**

**Neni 22
Mbrojtja e doktoratës**

1. Si rregull, mbrojtja e disertacionit bëhet e hapur me publik të kufizuar, përveç rasteve kur për arsye ndjeshmërie apo konfidencialitetit të çështjeve të trajtura, bëhet përjashtimisht e mbyllur.
2. Procedura për mbrojtjen ndjek hapat e mëposhtme:
 - a. Çelja e procedurës nga ana e kryetarit të jurisë, prezantimin e anëtarëve të jurisë, paraqitjen e dokumentacionit të dosjes, dhe deklarimit nga ana e tij për hapjen e procedurës së mbrojtjes.
 - b. Paraqitje prej 20-30 minutash e temës së doktoratës nga studenti;
 - c. Paraqitja e vlerësimit të dy oponentëve. Vlerësimi i oponentëve përmban elementet sipas formatit të paraqitur në shtojcën 2;
 - d. Pyetje nga anëtarët e tjerë të jurisë apo të pranishmit e interesuar dhe/ose me njohuri në fushën/nënfishën e kërkimit të punimit për doktorantin;
 - e. Diskutime dhe përgjigje e sqarime nga doktoranti dhe udhëheqësi;
 - f. Vlerësim i doktoratës nga anëtarët e jurisë përmes votimit të fshehtë;
 - g. Përpilimin e proceverbalit të vlerësimit dhe shpalljen e vendimit me shkrim.
3. Vlerësimi i mbrojtjes së punimit të doktoratës bëhet me pikë nga 0-100 sipas intervaleve të mëposhtme që u korrespondojnë këtyre vlerësimeve:
 - “shkëlqyeshëm” = 100 pikë të mundshme;
 - “shumë mirë” = 99-80 pikë të mundshme;
 - “mirë” = 79 – 65 pikë të mundshme;
 - “mjaftueshëm” = 64 – 50 pikë të mundshme;
 - “pakalueshëm” = 49 e më pak pikë të mundshme;
 - “nuk e mbrojt”.

Ai përftohet nga mesatarja e pikëve të caktuara nga secili anëtar i jurisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

4. Disertacioni i cili nuk ka kaluar mbrojtjen mund të ripunohet dhe të paraqitet për mbrojtje për herë të dytë, pas një periudhe prej 1 (një) deri 2 (dy) vjetësh, pas së cilës doktoranti humbet të drejtën për rimbrotje.
5. Pas mbrojtjes së disertacionit, njësia kryesore përcjell një kopje të tij në Bibliotekën Kombëtare, një kopje në Bibliotekën e Fakultetit të Shkencave Humane të UV-së dhe një kopje elektronike në Rektorat për publikim në faqen zyrtare të universitetit.
6. Lista e të diplomuarve në programet e doktoratës përcillet nga UV-ja në ministrinë përgjegjëse për arsimin, për t'u pasqyruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore e titujve akademikë dhe në regjistrat përkatës të UV-së.
7. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë për dhënien e gradës shkencore "doktor", e nënshkruar nga drejtuesi i njësisë kryesore dhe rektori.

Neni 23

Mospërfundimi ose ndërprerja e studimeve të doktoratës

1. Në rast ndërprerjeje të studimeve apo mospërfundimit të tyre brenda afatit të caktuar, doktoranti mund të pajiset me një vërtetim për rezultatet e arritura, i cili lëshohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe drejtuesi i njësisë kryesore.
2. Drejtuesi i njësisë kryesore vë në dijeni Komisionin për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor".

Neni 24

Transferimi i studimeve

1. Transferimi i një doktoranti të një IAL-je tjetër në një program studimi doktorate në UV, lejohet nëse:
 - a. studenti është pranuar në një program studimi doktorate në një IAL tjetër në të njëjtën fushë studimi me programin e doktoratës për të cilin ai/a jo po aplikon;
 - b. tema e tezës së disertacionit të studentit përkon me fokusin dhe fushën akademike të drejtuesve shkencorë të njësisë bazë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

2. Për t'u pranuar e regjistruar në programin e doktoratës, doktoranti i transferuar duhet të dorëzojë:
 - a. vërtetim të lëshuar nga IAL ku ka nisur programin e studimit të doktoratës, i cili duhet të japë të dhëna për fushën/nënfishën e studimit, formën e studimit, temën e disertacionit, kohëzgjatjen e studimeve të doktorantit pranë kësaj IAL-je.
 - b. vlerësimet vjetore të doktorantit.
 - c. trajnimi i kryer, programi individual i realizuar apo lëndët e ndjekura pranë IAL-së në kuadër të programit të doktoratës.
 - d. mendimin e udhëheqësit.
2. Dokumentacioni i doktorantit që dëshiron të transferojë studimet merret në shqyrtim nga komisioni *ad-hoc* për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve për doktorantë.

Neni 25

Anullimi i gradës shkencore “Doktor”

1. Anullimi i gradës shkencore “Doktor”, pas mbrojtjes së disertacionit, mund të vijë për një nga arsyet e mëposhtme:
 - a. konstatim të shkeljeve të Kodit të Etikës dhe Rregullores së Etikës në Kërkim dhe Botime në UV, parimeve të integritetit akademik dhe plagjiaturë të një mase mbi 20% të punimit.
 - b. mbrojtja e gradës shkencore është bërë në kundërshtim me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi.
2. Procedura për anulimin e gradës shkencore “doktor” nis me paraqitjen e konstatimeve/ ankesave për një nga shkeljet e mësipërme pranë Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “doktor”. Çështja i përcillet Këshillit të Etikës për shqyrtim. Pas trajtimit të saj, Këshilli i Etikës përpilon një raport, të cilin ia përcjell Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore “doktor”. Komisioni bën vlerësimet përkatëse të ankesës dhe gjetjeve dhe merr vendimin përfundimtar për anulimin ose jo të gradës shkencore “doktor”.
3. Në rast fillimi të një procesi të tillë, personi ndaj të cilit nis ky proces vihet në dijeni për arsyen dhe procedurën që do të ndiqet dhe informohet për të drejtën për t'u mbrojtur sipas legjislacionit në fuqi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

Neni 26

Rregullat për paraqitjen e punimit

1. Disertacioni hartohet në gjuhën shqipe së bashku dhe një përmbledhje e tij (2000–4000 fjalë) në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht, në format të shtypur dhe elektronik. Në raste të veçanta (*për studentë të huaj*) ai mund të shkruhet edhe në ndonjë gjuhë tjetër, por detyrimisht dorëzohet i përkthyer edhe në gjuhën shqipe.
2. Për hartimin e disertacionit ndiqen këto rregulla të përgjithshme:
 - a. Punimi duhet:
 - të jenë rreth 75, 000 fjalë;
 - të strukturohet sipas këtij rendi: faqja e titullit, deklarata e autorit, përkushtimi (nëse ka), mirënjohje, abstrakti dhe fjalët kyçe, përmbajtja, lista e tabelave, lista e figurave, lista e shkurtimeve, hyrja, kapitujt, përfundimet, referencat/bibliografia/literatura, shtojcat;
 - të ndjekë stilin MLA për citime, referenca dhe bibliografi;
 - të shkruhet në format A4, me hapësirë mes rreshtave 1.5 pt dhe me margjina 2.5 mm dhe një shtesë 1 cm në anën e lidhjes së punimit. Nuk do të përdoret header. Footer do të përdoret vetëm për numërimin e faqes;
 - të jetë i redaktuar nga një specialist gjuhe.
 - b. Ballina e disertacionit është me ngjyrë blu të errët dhe përmban:
 - emrin e universitetit (në krye, në mes të kopertinës);
 - emrin e fakultetit (në krye, në mes të kopertinës)
 - stemën e universitetit (në krye, në mes të kopertinës, sipër emrit të universitetit);
 - titullin 'Cikli i tretë i studimeve – Studimet e doktoratës' (në mes të kopertinës);
 - titulli i disertacionit (në mes të kopertinës), me shkronja kapitale, 14 masa e shkronjës
 - emrin dhe mbiemrin e kandidatit (në anën e majtë, në fund të kopertinës);
 - emrin dhe mbiemrin e mentorit (në anën e djathtë, në fund të kopertinës);
 - muajin dhe vitin e mbrojtjes së punimit të doktoratës (në mes të rreshtit, në fund të kopertinës).
 - Pjesa e pasme e kopertinës duhet të përmbajë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE SENATI AKADEMIK

Abstraktin në shqip dhe në anglisht. Secili variant duhet të përmbajë 200 fjalë duke u përdorur masa 10–she e shkronjës. Ky element duhet t'u mundësojë lexuesve vendas dhe të huaj të kuptojnë sesi është trajtuar çështja e marrë në studim. Abstrakti në anglisht është një kërkesë e standardeve ndërkombëtare.

Fushën dhe fjalët kyçe. Studenti në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor përcakton fushën dhe zgjedh fjalët kyçe në funksion të përshtatshmërisë së tyre me terminologjinë e përdorur në disiplinën përkatëse. Ato ndihmojnë identifikimin e tezës midis katalogëve kolektive në biblioteka.

2. Disertacioni lidhet në 5 (pesë) kopje origjinale të firmosura nga doktoranti dhe udhëheqësi shkencor;
3. Rregullat për paraqitjen dhe stilin e punimeve të doktoratës jepen në shtojcën I të kësaj rregulloreje.

Neni 27

Etika në kërkim dhe integriteti akademik

1. Çdo doktorant ka për detyrë të zbatojë rregullat e etikës në kërkim dhe integritetit akademik gjatë procesit hulumtues për mbledhjen e të dhënave, shkrimit të disertacionit dhe publikimeve që lidhen me procesin e doktoratës.
2. Doktoranti duhet të njihet paraprakisht me këto rregulla dhe të sigurohet përpara dorëzimit të dosjes se metoda hulumtuese e përdorur dhe procesi i mbledhjes së të dhënave nuk përmbajnë elemente të shkeljes së etikës në kërkim dhe se disertacioni dhe botimet e tij/saj nuk kanë shkelje të integritetit akademik.
3. Për të siguruar kontrollin antiplagjiaturë, njësia kryesore i mundëson kandidatit kontrollin e ngjashmërisë së punimit përmes softeve në dispozicion (*Ithenticate* dhe *AI Detection Capabilities*, sipas Nenit 4, Rregullore e Antiplagjiaturës së UV.)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

4. Në rast se disertacioni rezulton me ngjashmëri në masë më të madhe se 20%, doktoranti duhet të marrë në shqyrtim raportin e ngjashmërisë dhe të rishikojë punimin përpara dorëzimit përfundimtar.
5. Rregullat për etikën në kërkim dhe integritetin akademik detajohen në Rregulloren e etikës në kërkim dhe publikime në UV, Kodin e Etikës, dhe vendimet e posaçme të Senatit Akademik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

**KREU 5
DISPOZITAT KALIMTARE DHE TE FUNDIT**

Neni 28

Administrimi i dokumentacionit

1. Të dhënat e doktorantit ruhen në Fakultetin e Shkencave Humane në tri kopje.
2. Ato administrohen nga protokoll-arkiva e fakultetit, sekretaria mësimore që caktohet përgjegjëse për programin e doktoratës dhe zëvendësdekani për kërkimin shkencor.
3. Dokumentacioni që administrohet parashikon:
 - a. procedurat e zbatuara për hapat e ndryshme të programit të doktoratës (pranime, mbrojtje disertacioni, procesverbale komisionesh);
 - b. vendimet për kriteret dhe kuotat e pranimit;
 - c. planet individuale të doktorantëve;
 - d. të dhënat për projektet kërkimore-shkencore dhe zhvillimore të njësive bazë në funksion të programit të doktoratës;
 - e. dosjet e doktorantëve (kopja origjinale ruhet në arkivë);
 - f. raportimet vjetore për ecurinë e doktorantëve (sipas formatit në shtojcën 3);
 - g. të dhëna sasiore për numrin e doktorantëve të regjistruar dhe numrin e doktorantëve të cilët e kanë mbrojtur punimin e doktoratës (vetëm nga sekretaria mësimore dhe zëvendësdekani për anën shkencore).
4. Pas vlerësimit përfundimtar të dhënies së gradës shkencore “Doktor” nga Komisioni i Dhënies së Gradës Shkencore “Doktor”, dosja e plotë e kandidatit që përmban dokumentacionin e plotë të tij që prej aplikimit fillestar, vendimeve të komisioneve përkatëse deri në përfundimin e marrjes së gradës shkencore “Doktor” sëbashku me një kopje origjinale të firmosur nga udhëheqësi shkencor dhe doktoranti në formatin shkresor (hard copy) dhe një kopje elektronike (në disk/usb) të disertacionin, arkivohet me procesverbal në arkivën e fakultetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi, nga një komision i përbërë nga përgjegjësi i departamentit, sekretarja e studimeve të Doktoratës, Zv, dekani i



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE SENATI AKADEMIK

kerkimit shkencor, përgjegjesja e zyrës së protokollit dhe cdo person tjetëri ngarkuar sipas ligjit. Pas vendimit të dekanit për përcjelljen zyrtare të kopjeve të disertacionit në Bibliotekën Kombëtare dhe në Bibliotekën e Fakultetit, një kopje e printuar e disertacionit (hard copy), i dorëzohet me shkresë zyrtare, nga sekretarja e doktoratës, përgjegjësit të Bibliotekës së Fakultetit (FSHH), cili firmos për marrjen në dorëzim të tij. Një kopje e kësaj shkresë zyrtare është pjesë e dosjes që arkivohet.

Një kopje elektronike e disertacionit (soft copy), i dorëzohet me shkresë zyrtare, nga komisioni i mësipërm, zyrës së administrimit informatik të UV-së, për të vazhduar me publikimin online në faqen zyrtare të UV-së, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Pas kërkesës së disertantit, 1 kopje e printuar e disertacionit të mbrojtur i dërgohet nga dekani me shkresë zyrtare, Bibliotekës së Fakultetit (FSHH-së), dhe 1 kopje origjinale i dërgohet Bibliotekës Kombëtare (Tiranë), për depozitim sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 29

Dispozitat kalimtare dhe të fundit

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati i UV-së.
2. Shtojcat në vijim janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, me të cilën rregullohet edhe përdorimi i tyre:
 - Sh 1 – Për paraqitjen dhe stilin e punimeve të temës së doktoratës për programin e studimit “Doktoratë” në “Studime gjuhësore, letrare e kulturore”
 - Sh 2 – Format i paraqitjes së punimit
 - Sh 3 – Raportimet vjetore për ecurinë e doktorantëve
 - Sh 4 – Projektpropozimi për temën e doktoratës
 - Sh 5 – Vlerësimi i oponentit
 - Sh 6 – Fletëvlerësimi për temën e doktoratës
3. Kjo rregullore zbatohet për studentët që do të regjistrohen në programet e studimit të doktoratës pas hyrjes së saj në fuqi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

**Neni 30
Shfuqizime**

Me hyjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet rregullorja e mëparshme e miratuar nga Senati Akademik.

Miratuar me Vendimin e Senatit Nr. 43, datë 15.11.2021, i ndryshuar nga Senati Akademik me Vendimin Nr. 32, datë 16.06 2026

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK
PROF.DR AURELA SALIAJ**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

Shtojca 1

**Për paraqitjen dhe stilin e punimeve të temës së doktoratës për
programin e studimit “Doktoratë” në “Studime gjuhësore, letrare e kulturore”**

1

Objekti

Objekt i kësaj rregulloreje është standardizimi i mënyrës së paraqitjes së punimeve të temës së doktoratës nga doktorantët që ndjekin programin e studimit “Doktoratë” në “Studime gjuhësore, letrare e kulturore”. Për citimet dhe referencat, në përgatitjen e temës së doktoratës për këtë program studimi, do të ndiqet stili i MLA (Modern Languages Association).

2

Parime të përgjithshme

Disertacioni duhet të shkruhet dhe paraqitet detyrimisht në gjuhën shqipe. Shembujt ilustrues do të jenë në një nga gjuhët e programit të studimit (në anglisht për studentët që kanë ndjekur studimet “Master i shkencave” në gjuhën angleze, italisht për ata që kanë ndjekur studimet “Master i shkencave” në gjuhën italiane, shqip për ata që kanë ndjekur studimet “Master i shkencave” në gjuhën shqipe). Në rastet kur disertacioni shkruhet në gjuhë angleze ose italiane, ai detyrimisht dorëzohet i përkthyer edhe në gjuhën shqipe. Ato duhet të printohen në letër format A4. Kopjet që do të dorëzohen duhet të jenë të printuara qartë. Për shënime, duhet të përdorni futnots (*footnotes*) dhe jo shënime në fund të punimit (*endnotes*). Punimi do të shtypet me hapësirë 1.5. Theksimet me shkronja korsike (*italics*) dhe me të zezë (*bold*) do të përdoren vetëm aty ku është e nevojshme dhe në mënyrë të kursyer. Për aspekte të tjera të paraqitjes së punimit, mund t’i referoheni udhëzuesit të MLA, <https://style.mla.org/>.

Çdo punim duhet të përmbajë të paktën faqen e parë me të dhënat e temës, deklaratën për origjinalitetin e punimit, tabelën e përmbajtjes, mirënjohjen, abstraktin, temën, referencat.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

3

Struktura e punimit

Struktura e punimit duhet të ndjekë rendin e mëposhtëm, por mund të pësojë përshtatje në varësi të kërkesave të punimit.

- Faqja e titullit
- Deklarata e autorit
- Mirënjohje
- Abstrakt, fjalët kyçe
- Përmbajtja, lista e tabelave, lista e figurave
- Lista e shkurtimeve
- Hyrja
- Kapitujt
- Përfundimet
- Referencat/Bibliografia/Literatura
- Shtojcat

4

Gjatësia e punimit

Numri i fjalëve të punimit duhet të trajtohet me kujdes. Duke qenë se të gjitha punimet do të shkruhen në word, numërimi i fjalëve kryhet elektronikisht nga *software*-i.

Në numrin e fjalëve përfshihen: teksti kryesor, fusnotat, citimet në tekst dhe në fusnota.

Në numrin e fjalëve nuk përfshihen: kapaku dhe deklarimi, përmbajtja, ndonjë përkthim teksti, diçiturat, bibliografia.

Punimi i diplomës duhet të jenë 75, 000 fjalë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

5

Ortografia

Për ortografinë do të përdoret anglishte britanike në rastin e punimeve në gjuhën angleze, duke pranuar, megjithatë, forma të anglishtes amerikane të njohura nga *Oxford English Dictionary* (p.sh. – ize).

Për gjuhën italiane, do të ndiqen rregullat dhe ortografia e pranuar nga Akademia e Kruskës.

Për punimet në gjuhën shqipe, do të ndiqen rregullat e drejtshkrimit të shqipes.

6

Citimet

Citime deri në 60 fjalë në prozë ose deri në një varg poezie duhet të vendosen në thonjëza njëshe, përveç rasteve kur duhet të vihen në pah për qëllim analize ose theksimi, ato theksohen me shkronja korsike (*italics*) dhe nuk futen në thonjëza. Citimi që tejkalon këtë numër fjalësh duhet të veçohet me një hapësirë në tekstin e punimit. Në këtë rast, nuk përdoren thonjëzat apo nënvizimet. Thonjëzat dyshe do të përdoren vetëm për citime brenda citimit të cilat janë të vendosura në thonjëza njëshe. Në rast përkthimi të ndonjë fraze apo pasazhi të shkurtër, këto jepen me fusnota. **Kujdes:** përkthimi nuk përlllogaritet në numër fjalësh.

Për citimet brenda në tekst do të ndiqet mënyra “autor-faqe”, që do të thotë që mbiemri i autorit dhe faqja/faqet nga është marrë citimi do të jepen brenda në tekst në kllapa, kurse referenca e plotë në fund të punimit në listën e referencave. Kur mbiemri i autorit përmendet në tekst, në kllapa vendoset vetëm numri i faqes/faqeve. Për shembull:

Në të përditshmen tonë, ne përpiqemi “të përcjellim kuptime përmes krijimit dhe interpretimit të ‘shenjave’” (Chandler 13).

Chandler thotë se në të përditshmen tonë, ne përpiqemi “të përcjellim kuptime përmes krijimit dhe interpretimit të ‘shenjave’” (13).

Nëse burimi nuk ka autor, atëherë në kllapa vendoset titulli i shkurtuar dhe numri i faqes. Titulli i plotë dhe detajet e tjera të referencës vendosen në fund.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
SENATI AKADEMIK

“ëe see so many global ëarming hot spots in North America likely because this region has ‘more readily accessible climatic data and more comprehensive programs to monitor and study environmental change . . .’ (“Impact of Global ëarming” 6).

Titulli vendoset në thonjëza nëse punimi është i shkurtër (p.sh. artikull) dhe shkruhet me shkronja korsike (*italics*) nëse punimi është i gjatë (p.sh. libër, drame, ëebsite, programe televizive).

Në rastin kur citohen në tekst autorë me të njëjtin mbiemër atëherë nevojitet informacion shtesë për t’i dalluar. Në këtë rast vendosen edhe inicialet e emrit.

Although some medical ethicists claim that cloning ëill lead to designer children (R. Miller 12), others note that the advantages for medical research outëigh this consideration (A. Miller 46).

Kur citohen dy autorë, atëherë përmenden të dy në tekst ose në kllapa vendosen mbiemrat e të dyve dhe numri i faqes/faqeve.

Branston dhe Stafford e vënë theksin midis të tjerash tek natyra polisemike e shenjave: ‘shenjat nuk janë të fiksuara, apo të qëndrueshme, por gjithmonë polisemike, ose në gjendje që të kenë disa, për të mos thënë shumë kuptime dhe shoqërime. Njëfarë kontrolli mbi ambiguitetin vendoset përmes imazheve, veçanërisht për lajmet dhe reklamat, përmes përdorimit të titujve ose komenteve me zë’ (24).

‘Shenjat nuk janë të fiksuara, apo të qëndrueshme, por gjithmonë polisemike, ose në gjendje që të kenë disa, për të mos thënë shumë kuptime dhe shoqërime. Njëfarë kontrolli mbi ambiguitetin vendoset përmes imazheve, veçanërisht për lajmet dhe reklamat, përmes përdorimit të titujve ose komenteve me zë’ (Branston dhe Stafford 24).

Kur përmenden tre ose më shumë se tre autorë, përmendet vetëm autori i parë dhe emrat e tjerë zëvendësohen me *et al.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

According to Franck et al, 'Current agricultural policies in the U.S. are contributing to the poor health of Americans' (327).

The authors claim that one cause of obesity in the United States is government-funded farm subsidies (Franck et al. 327).

Kur citohet më shumë se një vepër nga i njëjti autor, atëherë përmendet edhe titulli i shkurtuar i punimit nga është marrë citimi:

Lightenor has argued that computers are not useful tools for small children ("Too Soon" 38), though he has acknowledged elsewhere that early exposure to computer games does lead to better small motor skill development in a child's second and third year ("Hand-Eye Development" 17).

Murray states that writing is 'a process' that 'varies with our thinking style' (*Write to Learn* 6). Additionally, Murray argues that the purpose of writing is to 'carry ideas and information from the mind of one person into the mind of another' (*A Writer Teaches Writing* 3).

Kur autori nuk përmendet në tekst, atëherë në kllapa vendoset mbiemri i autorit, pasuar nga titulli i shkurtuar dhe numri i faqes:

Visual studies, because it is such a new discipline, may be 'too easy' (Elkins, "Visual Studies" 63).

Për mënyrën sesi do të citohen burime të tjera me specifika të ndryshme, konsultoni MLA style guide.

7

Titujt dhe nëntitujt

Aty ku është e mundur, është mirë të përdoren titujt dhe nëntitujt për efekt qartësie mendimi. Titujt kryesorë duhet të jenë me *small capitals*, *Times New Roman*, në qendër. Nëntitulli duhet të jetë me shkronja të vogla (shkronja e parë me të madhe), korsike (*italics*) dhe në qendër. Rreshti i parë i tekstit menjëherë pas titullit kryesor dhe nënkryesor është i plotë, kurse rreshtat e parë të paragrafëve vijues janë me një hapësirë (tab 0,5).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

8

Numrat

Numrat duhet të jepen me fjalë kur janë më të vegjël se 100 dhe kur nuk janë pjesë e një reference të caktuar, e një matjeje, liste, tabele apo të dhëna të tjera statistikore, p.sh. “shekulli i njëzetë”, “dorëshkrim i fundshekullit të dhjetë”, “pesë raste”, por “300x 100mm”. Në çdo rast tjetër shprehen me numra.

9

Përdorimi i vizës

Kujdes duhet të bëhet me përdorimin e vizës. Duhet të dallohet viza ndarëse (*hyphen*) nga viza hapësirë (*en dash/en rule*) dhe viza lidhëse (*em dash*).

Viza ndarëse (*hyphen*), (-), do të përdoret në rastin e bashkimit të fjalëve të përbëra, si p.sh. ekonomiko-financiare, kërkimore-shkencore etj.

Viza hapësirë (*en dash/en rule; span*), (—), është më e zgjatur nga viza ndarëse, por më e shkurtër nga viza lidhëse dhe shërben për të treguar hapësirë ose intervale midis shifrave, datave, viteve, orareve dhe lexohet si “nga ... deri në”. Për shembull, 2000–2010; 09:00–10:00 etj. Zakonisht ky simbol nuk gjendet në tastierat e kompjuterëve të zakonshëm, por mund të përzgjidhet tek lista e simboleve (shko tek “Insert” dhe pastaj përzgjidh “Symbol”).

Viza lidhëse (*em dash*), (—), është më e zgjatur nga dy të parat dhe kryen disa funksione. Në varësi të kontekstit, ajo mund të përdoret në vend të presjes për të veçuar ndajshtimin, parantezës ose dy pikave.

10

Numërimi i faqeve të punimit

Numrat do të vendosen në fund të çdo faqeje, në qendër. Faqja e titullit nuk duhet të përmbajë numër faqeje. Numërimi fillon me deklaratën e autorit me numra romakë nga **ii** dhe vazhdon deri tek hyrja (e përfshirë). Numërimi me numra arabë fillon me kapitullin e parë nga **1**. Për të lehtësuar punën me numërimin e faqeve, duhet punuar me “section breaks” (shkon tek “page layout”, pastaj “breaks”, më pas “next page”).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE SENATI AKADEMIK

11

Formati i faqes

Punimi do të shkruhet në format A4. Marxhinat do të jenë 2,5 cm dhe një shtesë 1 cm në anën e lidhjes së punimit. Nuk do të përdoren header. Footer do të përdoret vetëm për numërimin e faqes.

12

Lloji i shkrimit

Madhësia e shkrimit:

- Për titujt e kapitujve: *Times New Roman* 14, bold
- Për nëntitujt: *Times New Roman* 12, bold
- Teksti i punimit: *Times New Roman* 12
- Për citimet në bllok, tabelat, figurat dhe titujt e tyre: *Times New Roman* 11
- Për futnotat: *Times New Roman* 10

13

Shembujt

Stili i shkrimit: Të gjithë shembujt jepen me shkronja korsike (përveç rasteve kur jepen fraza/fjali). Shembujt nuk futen në thonjëza.

Numërimi: Shembujt që nuk përfshihen në tekst duhet të numërohen dhe numrat të vendosen midis kllapave (parantezë). Për shembull: (1) *feet*, *geese*, *teeth*. Për të radhitur shembujt duhet të përdoret butoni “tab” dhe jo “space”. Shembujt numërohen sipas radhës në të gjithë tekstin. Referimet ndaj shembujve të numëruar duhet të bëhen në këtë mënyrë: “si tek (2) dhe (3)”.

14

Tabelat, figurat, diagramet, ilustrimet

Të gjitha tabelat, figurat, diagramet dhe ilustrimet duhet të numërohen sipas radhës përgjatë punimit dhe një listë e plotë e tyre (p.sh. Lista e tabelave) duhet të jepet pas tabelës së përmbytjes. Të gjitha duhet të përmbajnë tituj të posaçëm që përmbajnë numrin dhe një përshkrim konciz. Titujt për tabelat



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

vendosen sipër tyre, kurse për figurat, diagramet, ilustrimet vendosen nën to. Titujt vendosen në qendër.

15

Shtojcat

Shtojcat vendosen pas referencave dhe faqet e tyre numërohen në vazhdim të punimit. Ato radhiten me shkronja të mëdha (p.sh. Shtojca A) dhe mund të kenë edhe tituj. Shtojcat përfshihen në tabelën e përmbajtës. Referimet ndaj shtojcave duhet të bëhen në këtë mënyrë: “Të dhënat jepen në Shtojcën A, fq. 57”.

16

Referencat

Formati i përgjithshëm për çdo reference të cituar është:

a. Libër me një autor:

Mbiemri, emri i autorit. *Titulli i librit*. Botuesi, viti i botimit.

Për shembull:

Kramsch, Claire. *Context and Culture in Language Teaching*. Oxford University Press, 1993.

b. Libër me dy autorë:

Mbiemri, emri i autorit të parë dhe emri e mbiemri i autorit të dytë. *Titulli i librit*. Botuesi, viti i botimit.

Për shembull:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
SENATI AKADEMIK

Gillespie, Paula, and Neal Lerner. *The Allyn and Bacon Guide to Peer Tutoring*. Allyn and Bacon, 2000.

c. Libër me tre ose më shumë autorë:

Mbiemri, emri i autorit të parë et al. *Titulli i librit*. Botuesi, viti i botimit.

ëyssocki, Anne Frances, et al. *ëriting Neë Media: Theory and Applications for Expanding the Teaching of Composition*. UtahState UP, 2004.

d. Dy ose me shume libra nga i njëjti autor:

Librat rëdhiten në mënyrë alfabetike sipas titullit (në anglisht, nyjat nuk llogariten në radhitjen alfabetike, por emri që vjen pas tyre). Mbiemri, emri i autorit vendosen vetëm për titullin e parë. Për titujt që vijnë vendoni tri viza dhe një pikë në vend të emrit të autorit, si më poshtë:

Palmer, William J. *Dickens and Neë Historicism*. St. Martin's, 1997.

---. *The Films of the Eighties: A Social History*. Southern Illinois UP, 1993.

e. Për përktthime apo vëllime të redaktuara vepohet si më poshtë:

Foucault, Michel. *Madness and Civilization: A History of Insanity in the Age of Reason*. Translated by Richard Hoëard, Vintage-RandomHouse, 1988.

Shakespeare, ëlliam. *The Tempest*. Edited by John Dover ëilson. Cambridge University Press, 2008.

d. Për përmbledhje vepohet si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

Peterson, Nancy J., editor. *Toni Morrison: Critical and Theoretical Approaches*. Johns Hopkins UP, 1997.

f. Për artikuj apo kapituj të shkëputur nga vëllime apo buletine, veprohet si më poshtë:

Mbiemri, emri i autorit. "Titulli i punimit." Titulli i vëllimit, përmbledhur nga emri/emrat e redaktorëve, Botuesi, viti i botimit, faqet.

Për shembull:

Leggatt, Alexander. "Shakespeare's Comedy of Love: The Comedy of Errors." *The Comedy of Errors: Critical Essays*, edited by Robert S. Miola, Garland Publishing Inc., 1997, 135-154.

a. Për punime pa autor veprohet si më poshtë:

"The Impact of Global Farming in North America." *Global Farming: Early Signs*. 1999.
ëeb. 23 Mar. 2009.

Për shembuj të tjerë më specifike të paparashikuar këtu, ju lutem konsultoni MLA style guide.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
SENATI AKADEMIK**

Shtojcë 2 – Formati i paraqitjes së punimit



Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë

Fakulteti i Shkencave Humane

Cikli i tretë i studimeve – Studimet e doktoratës

TITULLI

Doktoranti
Emër Mbiemër

Drejtuesi shkencor
Titulli Emër Mbiemër

muaji viti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

Deklarata e autorit

Unë, i nënshkruari, deklaroj se jam autori i vetëm i kësaj teme. Në dijeninë, kjo temë nuk përmban asnjë material të botuar më parë nga ndonjë person tjetër. Kjo temë nuk përmban asnjë material që është pranuar si pjesë e kërkesave të ndonjë programi tjetër studimi, në anglisht ose në ndonjë gjuhë tjetër. Kjo është një kopje e vërtetë e temës, duke përfshirë rishikimet përfundimtare.

Data:

Emri (gërma shtypi):

Nënshkrimi:



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK**

Mirënjohje

Unë do të doja t'i shpreh ... udhëheqësit tim, për.... . Unë gjithashtu i jam falënderuese
..... time/ dua të falënderoj ..., ..., për....

Gjithashtu, falënderoj ... për....

Vlorë, muaj viti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

Abstrakt

Tema ka të bëjë me Më specifikisht, Do të tregohet se.....

Kjo temë ka të bëjë edhe me.... Premisa kryesore e temës është.... Për këtë qëllim ...

Qëllimi është që....

Kjo temë gjithashtu shqyrton se si.... Kjo temë....

Fjalë kyçe:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

Pasqyra e lëndës

Deklarata e autorit.....	i
Mirënjohje.....	i
Abstrakti.....	ii
Hyrje.....	vi
KAPITULLI 1. Sfondi teorik.....	1
KAPITULLI 2. Pjesa studimore.....	8
2.1. Hyrje	8
2.2. Metodologjia	8
2.2.1. Materialet dhe instrumentet e përdorura për hulumtimin	8
2.2.2. Pjesëmarrësit në studim	9
2.2.3. Mbledhja e të dhënave.....	10
KAPITULLI 3. Analiza e të dhënave	11
KAPITULLI 4. Rezultate dhe diskutime	22
KAPITULLI 5. Konkluzione	25
5.1.....	27
Bibliografia.....	29
Shtojca A	33
Shtojca B	35



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

Shtojca C	37
Shtojca D	39
Shtojca E	41

Lista e tabelave

Tabela 1.	11
Tabela 2.	12
Tabela 3.	14
Tabela 4.	14
Tabela 5.	15
Tabela 6.	18
Tabela 7.	20



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

Lista e figurave

Figura 1.	17
-----------------------	-----------



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

HYRJE

(Plotësohet nga studenti.....)

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

KAPITULLI 1
SFONDI TEORIK

(Plotësohet nga studenti.....)

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

KAPITULLI 2

PJESA STUDIMORE

2.1. Hyrje

(Plotësohet nga studenti.....)

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
SENATI AKADEMIK

(Plotësohet nga studenti.....)

[illegible]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

2. 2. 1. Materialet dhe instrumentet e përdorura për hulumtimin

(Plotësohet nga studenti.....)

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

(Plotësohet nga studenti.....)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

Tabela 1.

(Plotësohet nga studenti)

Pyetja	Përqindja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK




Figura 1.(Emërtimi i figurës)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

KAPITULLI 4

REZULTATE DHE DISKUTIME

(Plotësohet nga studenti.....)

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMAL' VLORE
SENATI AKADEMIK

KAPITULLI 5
KONKLUZIONET

(Plotësohet nga studenti.....)

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

REFERENCAT/BIBLIOGRAFIA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

SHTOJCA A

PYETËSOR

(Plotësohet nga studenti.....)

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
SENATI AKADEMIK

Shtojca 3

Raportimi vjetor për ecurinë e doktorantëve

STUDIMET E CIKLIT TE TRETE – DOKTORATË

Emri dhe mbiemri i doktorantit	
Numri i identifikimit	
Fakulteti	Fakulteti i Shkencave Humane, UV
Programi i studimit	“Doktoratë” në “Studime gjuhësore, letrare e kulturore”
Data e fillimit të studimeve	

Raport për ecurinë e doktorantit

Viti	Semestri	Akivitete/et e parashikuara sipas programit individual të aftësisht	Periudha e realizimit	Komente/informacion shtesë
I	1	- Pjesëmarrje në trajnime, ëorkshop-e, leksione		
	2	- Vlerësim dhe miratim i planit të doktoratës - Studim i literaturës që lidhet me temën e disertacionit - Pjesëmarrje në leksione		
II	1			
	2			
III	1			
	2			
IV	1			
	2			
V	1			
	2			



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

Doktoranti

Nënshkrimi

Data e nënshkrimit

Drejtuesi shkencor

Nënshkrimi

Data e nënshkrimit

Koordinatori i programit

Nënshkrimi

Data e nënshkrimit

Dekani

Nënshkrimi

Data e nënshkrimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

Shtojca 4

PROJEKTPROPOZIMI PËR TEMËN E DOKTORATËS

1. Të dhëna të përgjithshme

Emri i studentit:

Programi i studimit:

Udhëheqësi i propozuar:

2. Përshkrimi i projekpropozimit

➤ *Titulli i temës:*

(Këtu jepet një titull i qartë i temës për projektin kërkimor që përmban fjalë kyçe që e identifikojnë dhe përshkruajnë menjëherë atë.)

➤ *Fusha/nënfusha:*

(Këtu jepet fusha dhe nënfusha të cilës i përket objekti i hulumtimit shkencor të projektit kërkimor.)

➤ *Abstrakti:*

(Një sintezë prej 250-300 fjalësh e studimit të planifikuar që përfshin këto elemente: qëllimin e studimit, pyetjet dhe hipotezat, metodologjinë e hulumtimit, rezultatet e pritshme, diskutime.)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
SENATI AKADEMIK

➤ *Fjalët kyçe:*

(Këtu jepen fjalë kyçe që përfaqësojnë përmbajtjen e studimit dhe lidhen me fushën/nënfishën e studimit.)

➤ *Hyrja:*

(Një përmbledhje e qartë për objektin e studimit, pse është i rëndësishëm, interesant, relevant dhe realist.)

➤ *Sfondi teorik:*

(Përmbledhje e njohurive të sfondit teorik dhe kontekstit të (nën)fushës së kërkimit, duke përfshirë literaturën kryesore, autorët kyç, gjetjet kryesore të kërkimit.)

➤ *Formulimi i problemit dhe qëllimet e hulumtimit:*

(Përshkrim i qartë dhe konciz i çështjeve që duhet të trajtohen - cili është problemi specifik në këtë hulumtim në këtë fushë studimi, përse po ndërmerret ky studim.)

➤ *Pyetjet dhe hipotezat e hulumtimit:*

(Formulimi i problemit në pyetje dhe hipoteza me qëllim hulumtimin e tyre përmes metodologjisë së përshtatshme për kërkimin në fjalë.)

➤ *Metodat dhe teknikat e hulumtimit:*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
SENATI AKADEMIK

(Metodologjia e kërkimit përcakton metodat e kërkimit dhe hapat logjike - Çfarë duhet bërë dhe si të zgjidhet problemi dhe arrihen objektivat e propozuar objektivat? Cilat metoda kërkimore do të përdoret?)

➤ *Rezultatet e hulumtimit:*

(Përmbledhje e rezultateve të pritshme.)

➤ *Literatura:*

(Listë paraprake e literaturës së parashqyrtuar dhe në dispozicion të studimit.)

Plani i punës:

<i>Periudha kohore</i>	<i>Aktivitetet që do të realizohen</i>
<i>Viti i parë</i>	
muaji, viti – muaji, viti	
<i>Viti i dytë</i>	
<i>Viti i tretë</i>	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
SENATI AKADEMIK**

Shtojca 5

VLERËSIMI I OPONENTIT

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë

Fakulteti _____

Departamenti _____

Programi i Studimit _____

Fusha/Nënfusha _____

Emri i studentit: _____

Titulli i temës së doktoratës:

Oponenti

Universiteti ku punon _____

Raporti i vlerësimit

(Raporti duhet të përfshijë:

1) një vlerësim i përgjithshëm të temës, veçanërisht duke komentuar cilësinë e prezantimit, origjinalitetin dhe risinë e rezultateve, cilësinë teknike, ndikimin e domethënien e kërkimit të propozuar.

2) Çështje specifike si korrigjime, pyetje, sugjerime për përmirësime për kandidatin.)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

- 1. Hyrje**
- 2. Konteksti dhe sfera i studimit**
- 3. Përshkrim i përgjithshëm i temës së doktoratës**
- 4. Komentë dhe pyetje të veçanta**
- 5. Vlerësimi përfundimtar**
- 6. Përfundime**

Në këtë disertacion, doktoranti ka dëshmuar aftësitë e tij/saj krijuese e hulumtuese në fushën e studimit/kërkimit:

Po Jo

Rekomandoj mbrojtjen e disertacionit

Po Jo

Data

Nënshkrimi i oponentit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

Shtojca 6

VLERËSIMI I JURISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE

FAKULTETI _____

DEPARTAMENTI _____

PROGRAMI I STUDIMIT _____

FUSHA/NËNFUSHA _____

FLETË-VLERËSIMI PËR TEMËN E DOKTORATËS

Emri i studentit: _____

Titulli i temës së doktoratës: _____

Nr.	Kriteret e vlerësimit	Pikët e parashikuara	Pikët e fituara
1	Demonstrimi i një vetëdijeje profesionale në trajtimin e çështjes së zgjedhur (përcaktimi i qartë i çështjes kërkimore, përputhja e trajtesës me temën, përshkrimi dhe analiza e thellë e rezultateve, paraqitja e përfundimeve dhe rekomandimeve).	25	
2	Përdorimi i metodologjisë shkencore dhe i instrumenteve të kërkimit (përcaktimi i detyrës shkencore në përputhje me temën, përcaktimi i hipotezave ose i pyetjeve kërkimore, përcaktim i subjekteve, i kampionit, përzgjedhja e metodave dhe e instrumenteve të përshtatshëm).	15	
3	Originaliteti i punimit (formulimi origjinal i temës, këndvështrimi origjinal i temës, struktura origjinale, rezultate dhe analiza origjinale).	20	
4	Dobia e punimit (dobia e punimit për zhvillimin e teorisë,	15	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
SENATI AKADEMIK

	për zbatimin në praktikë, për studime të mëtejshme).		
5	Cilësia e të shkruarit (respektimi i stilit shkencor të të shkruarit dhe i rregullave të drejtshkrimit).	15	
6	Paraqitja teknike (respektimi i kërkesave teknike të formatit të punimit).	5	
7	Cilësia e prezantimit.	10	
	Shuma e pikëve	100	

Komisioni i vlerësimit:

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.
- 5.

VLORE, më _____

Shënim: E njëjta fletë-vlerësimi përshtatet për vlerësimet individuale të anëtarëve të komisionit.